



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në
“Fagot dhe Mësuesi”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Astrit Mustafa

2. Dr. Pranvera (Puka) Kraja

Nëntor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional/ i Shkencave/Arteve/ Program i Integruar
i Nivelit të Dytë në “Fagot dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti i Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 397, datë 10.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR Nr. 821, datë 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 142, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14/4
18	Numri i studentëve:	5
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të nivelit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve 'Fagot dhe Mësuesi' ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve. Programi Master i Arteve është miratuar për hapje e tij me dokumentin e licencimit me Urdhër MASH Nr. 397, datë 10.08.2011 me emërtimin Master i Arteve të Bukura në "Fagot". Ndërsa me Urdhër të MASR, Nr. 821, datë 26.12.2018¹ u bë riorganizimi i Masterave në Universitetin e Arteve. Sipas këtij Urdhëri, në pikën 1/a të tij, ky program studimi nga emërtimi Master i Arteve të Bukura në "Fagot", riorganizohet në Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi". Emërtimi i diplomës është Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", në sistemin 2-vjeçar me kohë të plotë, me Urdhër nga MASR, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme, Nr.142, datë 19/09/2018.

Programi Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" është në përputhje të plotë me strategjinë dhe politikat e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë të duhura akademike që i formojnë ata si profesionistë në profilin e mësuesisë së instrumentit fagot. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në dy vite akademike. Programi realizohet në gjuhën shqipe. Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, kanë hapur dhe zhvilluar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës dhe përditësimeve periodike, në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë. Programi studimor i ciklit të dytë, Master i Arteve 'Fagot dhe Mësuesi', ndjek udhëzimet nga Ministria e Arsimit si dhe ngjashmërinë e kurrikulave me standartet europiane.

Departamenti i Interpretimit përbëhet nga një staf prej 14 pedagogë PAE dhe 4 PAE, të cilët janë të kualifikuar me tituj dhe më grada shkencore, sipas dispozitave ligjore. Departamenti i Interpretimit ka nënshkruar marrëveshje me institucione të shumta për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, edhe për realizimin e aktiviteteve artistike.

Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" ndër vite është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 0 student
- Për vitin akademik 2021-2022 është 1 student
- Për vitin akademik 2020-2021 është 2 studentë (1 student ka ndërprerë studimet)
- Për vitin akademik 2019-2020 është 2 studentë

Gjithsej 5 studentë. Të diplomuar 4 studentë.

Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.

¹ UMASR Nr. Nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve". Evidenca II.4.3.4.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në dhjetor të vitit 2022, në komunikim të përbashkët për përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Vizitat u realizuan dy ditë, konkretisht me datat 6-7 dhjetor 2022.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në të poseduara prej ASCAL.

Gjatë dy ditëve të takimeve Grupi i vlerësimit të Jashtëm i përbërë nga Prof.Asoc. Astrit Mustafa dhe Dr.Pranvera Kraja (Puka) zhvilluan takime me Dekanin e Fakultetit të Muzikës, me Përgjegjës të Departamentit të Interpretimit, Shefin e Sektorit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës dhe Alumni, Sekretarinë mësimore dhe me studentë të këtij program studimi. Në ditën e dytë u vizituan ambientet e UART, sallat e lektoriemeve, salla e digjitalizuar si dhe biblioteka dhe salla e dëgjimit e pajisur me kompjuter. Për shkak të punimeve të restaurimit të hapësirave në përgjithësi nuk ishte e mundur të vizitohen sallat e koncerteve.

GVJ gjatë takimeve me grupet e caktuara u fokusua në bashkëbisedime konkrete për tema të caktuara si mekanizmi dhe fuqizimi i Njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, procesimin e mëtejshëm të pyetësorëve, për aktivitetet koncertale të stafit dhe studentëve, për projektet ndërkombëtare të fituara, për planin mësimor, kualifikimin e stafit, etj.

Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UART.

Koordinator teknik dhe shumë bashkëpunues me GVJ nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Endra Velaj.

Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

Me datë 25/07/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/101 Prot, Datë 25/07/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 734/2 Prot, Datë 06/09/2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Universiteti i Arteve lidhur me DRVJ, sqaron si më poshtë:

Mbi komentet e Universitetit të Arteve lidhur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë **Master i Arteve në “Fagotë dhe Mësuesi”** të këtij Institucioni.

Komentet lidhur me plotësimin e sugjerimeve të Intitucionit:

Standardi II.4/Kriteri 5: Mendimi i GVB-ës (komenti 1)

Standardi II.4/Kriteri 2 dhe Kriteri 5: Mendimi i ekspertëve (GVJ)

Duke respektuar përgjigjen e dhënë nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në lidhje me përditësimin e programeve të studimit, biem dakord me mendimin e GVB-së që këto programe mund të përmirësohen vetëm pas disa cikleve të diplomit të studentëve që ndjekin studimet Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”.

Në lidhje me rekomandimin për përfshirjen e lëndës së Metodave të kërkimit shkencor në këtë program studimi, pranojmë mendimin e paraqitur nga UART, se meqenëse për shkak të Statutit të veçantë që ka ky institucion ku drejtimi artistiko-shkencor është fokusi kryesor i formimit të studentëve, mjafton lënda e Shkrimit akademik për plotësimin e nevojave të studentëve për shkrimin e një punimi diplome.

Prandaj, konkludojmë që rekomandim i GVJ-së për këtë kriter, bie dhe standardi II.4, kriteri 2 dhe kriteri 5 përmbushen plotësisht.

Standardi III.3/Kriteri 2: Mendimi i GVB-ës (komenti 2)

Standardi III.3/Kriteri 2: Mendimi i ekspertëve (GVJ)

GVJ vlerëson dhe pajtohet me përgjigjen e dhënë nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm lidhur me kontrollin me anë të sistemit elektronik dhe antiplagjiaturë të provimeve.

Prandaj, konkludojmë se standardi III.3 përmbushet plotësisht.

Standardi IV.5/Kriteri 2: Mendimi i GVB-ës (komenti 3)

Standardi IV.5/Kriteri 2: Mendimi i ekspertëve (GVJ)

Duke respektuar përgjigjen e dhënë nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në lidhje me hartimin e raportit financiar të kostove dedikuar Departamentit të Interpretimit që është përgjegjës për programin e studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, dhe duke marrë parasysh numrin relativisht të ulët të studentëve për vetë specifikën e UART, biem dakord me mendimin e GVB-së që raporti financiar realizohet vetëm nga administratori dhe Drejtorja Ekonomike e UART, ndërsa DI paraqet kërkesat për mbulimin e shpenzimeve financiare.

Prandaj, konkludojmë që rekomandim i GVJ-së për këtë kriter, bie dhe standardi IV.5 përmbushet plotësisht.

Standardi V.4/Kriteri 1: Mendimi i GVB-ës (komenti 4)

Standardi V.4/Kriteri 1: Mendimi i ekspertëve (GVJ)

GVJ vlerëson përgjigjen e dhënë nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm lidhur me specifikën e instrumentit të Fagotit, i cili nuk është shumë i përdorur masivisht në orkestra dhe ansamble muzike dhome.

Rekomandimi ynë në lidhje me gjetjen e mekanizmave të duhur për rritjen e numrit të studentëve fagotistë në Master në “Fagot dhe Mësuesi”, ka të bëjë me gjetjen e mënyrave për bashkërendimin e punës me shkollat e mesme artistike të vendit dhe me ciklet AMU dhe AML për të siguruar vijimësinë e studentëve fagotistë nga këto cikle, dhe më e rëndësishmja, bërjen e propozimeve specifike Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit, për rregullimin apo inkurajimin e kësaj vijimsie. Rekomandimi i bërë nga GVJ është sinkron me rekomandimin e bërë nga vetë institucioni, i cili në faqen 143 të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të tij, shprehet pikërisht për “Gjetjen e mekanizmave, bashkëpunimeve dhe bashkërendimin e punës me institucionet e arsimit parauniversitar për ekuilibrimin e propocioneve të futjes së nxënësve në klasat e instrumenteve të frymës”.

Prandaj, konkludojmë se ky rekomandim i bërë nga GVJ qëndron dhe standardi V.4 përmbushet kryesisht.

Standardi VI.5/Kriteri 3: Mendimi i GVB-ës (komenti 5)

Standardi VI.5/Kriteri 3: Mendimi i ekspertëve (GVJ)

Duke respektuar përgjigjen e dhënë nga GVB në lidhje me rekomandimin tonë për hartimin e një plani masash ku të adresohen problematikat e evidentuara nga Raporti i akreditimit institucional, shprehemi se në kohën kur u bë vlerësimi i këtij program studimi (Dhjetor 2022), Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë në UART, nuk ishte ngritur akoma. Sipas përgjigjes së GVB-së, në shkresën zyrtare të UART drejtuar ASCAL me Nr. prot. 734/2, datë 06.09.2023, ky komision është ngritur me datë 09.02.2023, që rezulton të jetë ngritur dy muaj pas vizitës së GVJ-së në UART.

Prandaj, theksojmë se ky rekomandim është i vlefshëm për kohën kur u bë vlerësimi i këtij program studimi dhe konkludojmë se standarti VI.5 përmbushet kryesisht.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” ofruar nga Departamenti i Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve bën pjesë në përgatitjen dhe formimin universitar të institucionit dhe ka synim një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të formimit me karakter akademik, artistik dhe shkencor në fushën e arteve.</p> <p>Nga përmbajtja (syllabuset) si dhe nga strukturimi (sipas veprimtarive ABCDE) si vazhdimësi e programeve bachelor që ofrohen nga ky department, ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe krijon mundësi dhe potenciale për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare.²</p> <p>Nga ana tjetër edhe personeli akademik me kohë të plotë dhe ai i angazhuar me kohë të pjesshme, pjesë e stafit të këtij program studimi, janë pjesë e përfaqësimit në nivele të larta të vlerave akademike e sidomos atyre kulturore në shkallë kombëtare e më gjërë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” i Departamentit të Interpretimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e Universitetit të Arteve e shprehur në Statutin e Universitetit të Arteve, në nenin 4 të tij.³</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.</p>	<p>Nga verifikimi i bërë strategjisë së zhvillimit të institucionit 2018-2025, rezulton se programi i studimit të nivelit të dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është në përshtatje dhe në zbatim të saj, si dhe statutit të këtij institucioni.⁴</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje edhe me fushën e veprimtarisë të këtij institucioni që është Arti dhe në mënyrë me specifike, me fushën e Artit Muzikor, në përputhje edhe me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Nga analiza e planit mësimor rezulton se ky program studimi ka të integruar edhe element të masterit në fushën e mësuesisë, me lëndë për një formim profesional që përbëjnë 30 kredite, duke synuar që të përbushë kërkesat që burojnë nga ligji për programin Masteri në Arte, për studime të thelluara në fushën shkencore, por edhe duke sjellë një risi</p>

² Statuti i Universitetit të Arteve

³ Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

⁴ Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025.

	duke synuar që të realizojë edhe studime në aspektin profesional të mësuesisë. ⁵		
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Konstatohet se, programi i studimit, Master i Arteve 'Fagot dhe Mësuesi', është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare, më ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015, në përgjigje të nevojave të tregut të punës.^{6, 7}</p> <p>Politikat e Universitetit të Arteve, me statusin e veçantë si dhe me profilet e specifike të studimeve, mundësojnë regjistrimin dhe diplomimin e studentëve të paktë në numër dhe të mirëspecializuar (shiko mesazret e diplomimit në vite) dhe të përgatitur për tregun e punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fagotistë të kualifikuar për të performuar të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të ansambleve si dhe pjesëtar të orkestrave simfonike dhe frymore apo formacioneve të muzikës moderne; • Mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar; • Pedagogë për lëndët Fagot, Muzikë Dhome, Dëshifrazh dhe Vështirësi Orkestrale pranë FM të UART; • Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore 		
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se programi i studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mesuesi" ka synim një zhvillim të balancuar dhe të qendrueshëm të formimit me karakter akademik, artistik dhe shkencor të studentëve në fushën e arteve. Programi i studimit i përmbush të gjitha kërkesat kombëtare dhe është konfor zhvillimit strategjik dhe dokumenteve rregullatore të Universitetit të Arteve.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të Universitetit të Arteve, Fakultetit të Muzikës, Departamentit të Interpretimit, specifikisht programit të Master i Arteve në 'Fagot dhe Mësuesi', si dhe vizitës së GVJ-së në institucion, konstatohet se, një përvijë e gjatë e institucionit (që tashmë gëzon edhe statusin e veçantë) me një histori në themelimin e shkencës së artit për herë të parë në vendin tonë, gëzon përvijë në shtrirje kohore në të dy shekujt

⁵ Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve 'Fagot dhe Mësuesi'

⁶ Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor

⁷ Raporti Vjetor i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve

	(60 vite që prej hapjes së institucionit). Kjo përvojë rezultoi e konsoliduar nëpërmjet aktiviteteve të shumta kulturore shkencore, me profilin e stafit akademik në fushën e artit, si dhe gëzon të gjithë kapacitetet akademike si burime njerëzore dhe infrastrukturore. ^{8, 9, 10}
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga analiza e planeve mesimore të programit të studimit të nivelit të dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” dhe planeve të nivelit bachelor që mbulon njësia kryesore Fakulteti I Muzikës, rezultoi se programi është në një linjë me fushën akademike të njësies kryesore, e përditësuar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin sipas direktivave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe atyre evropiane. Një verifikim në rregulloren e studimit të institucionit në kreu i V, Kërkimi artistik Shkencor (në nenet 42;43;44) si dhe në rregulloren e programit Master I Arteve ¹¹ në “Fagot dhe Mësuesi”, rezultoi se edhe kërkimi artistiko shkencor, synim i këtij programi është në përputhje me veprimtarinë dhe fushën kërkimore të njësies kryesore dhe të institucionit. ¹²
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Nga shqyrtimi I dokumentacionit të paraqitur si dhe duke ju referuar International Standard Classification of Education (ISCED), rezultoi se programi i studimit të nivelit të dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është në përputhje me fushën akademike kërkimore (Arte kodit 021 si fushë e përgjithshme dhe Muzike dhe arte performuese kodit 0215 si fushë specifike) të njësies bazë që është Departamenti i Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Universiteti i Arteve nuk ofron “Master profesional” në një drejtim specifik jashtë profilit të institucionit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Programi Master i Arteve ‘Fagot dhe Mësuesi’ nga Departamenti i Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, nëpërmjet politikave të brendshme të paraqitura në rregullore dhe planin strategjik 2018-2025, si dhe profilit të Universitetit të Arteve, ofrojnë trajnime profesionale të paraqitura si aktivitete kulturore, për studentët aktual dhe për të diplomuarit (alumni). ¹³ Trajnimet profesionale paraqiten si veprimtari artistike dhe kulturore. Gjithashtu, angazhimi në projekte akademike si Erasmus+, Erasmus + KA2, etj. Universiteti nëpërmjet politikave të tij, mundëson zhvillimin dhe mbajtjen e lidhjeve me studentët të cilët janë alumni nga institucioni.

⁸ Profili i stafit akademik, CV, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve, www.uart.edu.al

⁹ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022.

¹⁰ Biblioteka e Universitetit të Arteve, <http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=70&niveli=56>

¹¹ Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Fagot dhe Mësuesi

¹² Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022

¹³ Aktivitete kulturore shkencore, Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025.

	Një element shumë i rëndësishëm për tu theksuar, është përfshirja e studentëve aktual dhe të diplomuar në aktivitet e akademike të përkthyer si koncerte artistike.		
Konkluzione	<p><i>GVJ duke u mbështetur në dokumentat e paraqitur dhe të verifikuar gjatë vizitës është i mendimit se programi i studimit Master i Arteve në Fagot dhe Mësuesi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p> <p><i>Në institucion ekziston një strukturë e brendshme funksionale që bën të mundur të përmbushë qëllimet e misionit të institucionit konform ligjit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga GVB konstatoam se institucioni ka hartuar dhe miratuar një sërë udhëzimesh dhe rregulloresh të cilat sigurojnë një bashkëpunim dhe ndarje detyrash mes njësisë dhe administraes për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Në statutin e institucionit në disa nene të tij si dhe në rregulloret e tërë njësisë të institucionit janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse të punës, dhe bëhet një analizë e vazhdueshme e rezultateve të arritura.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kishte një bashkëpunim efektiv mes këtyre njësisë dhe njohje e plotë e detyrave dhe detyrimeve që ato kishin.</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Universiteti i Arteve, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, institucione të arsimit parauniversitar dhe institucione administrative brenda vendit. Profili i universtitit, si dhe jetëgjatësia e këtij institucioni, është konsoliduar me marrëveshje institucionale të shumta. ^{14, 15}
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se Fakulteti i Muzikës ka një sërë marrëveshjesh në ndihmë të përmisimit të procesit mësimor. Janë bërë përpjekje edhe për të realizuar marrëveshje per praktikën profesionale e cila është e një natyre të vecantë, pasi lidhet me pjesmarrjen e studentëve në veprimtari apo aktivitete që realizohen nga institucione të caktuara kulturore si Teatri Kombëtar I Operas dhe Baletit, Orkestra Simfonike RTSH, Ansambli Popullor etj, Ndonëse është

¹⁴ Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020

¹⁵ Marrëveshje me Drejtoritë e Përgjithshme të ZVA / shembull /ZVA Vlorë

dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	paraqitur një tabelë nr.5 lidhur me marrëveshjet me institucione dhe organizata bashkëpunuese në rang programesh, dhe një evidencë marrëveshjeje me ZVA Vlorë për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, gjatë takimit në institucion u njohëm edhe me dokumenta të tjerë që tregonin për marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha ZVA-të ku studentët kanë bërë apo do të bëjnë praktikën mësimore. ^{16, 17}								
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Konstatohet se informacioni i hartuar për përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet, siç janë ato të projekteve dhe shkëmbimit të studentëve, janë në vazhdimësi për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Vazhdimësia e projekteve dhe e shkëmbimeve u kufizua në vitin 2020 të pandemisë globale COVID -19 e cila mbylli mundësinë e shkëmbimeve për studentët dhe pedagogët për paraqitje fizike, por mundësoji bashkëpunimin online me masterclass të ndryshme. Raportet analitike vjetore për përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet, në funksion të realizimit të programit të studimit. ¹⁸								
Konkluzione	<i>GVJ, nisur nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, deklaroi se UART dhe Fakulteti i Muzikës si pjesë e tij ka një sërë marrëveshjesh me universitete dhe institucione të tjera që ndihmojnë për një cilësi në realizimin e programit të studimit Master I Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" si dhe për një aftësim profesional si artistik ashtu edhe mësimdhënës. UART ka programe studimi dypalëshe me partnerë të huaj që është një garanci më shumë për realizim cilësor të programit.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

¹⁶ Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020

¹⁷ Marrëveshjet, Faqja zyrtare online e UA , <http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=1089&niveli=95>

¹⁸ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Fakulteti I Arteve, 2021-2022.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga analiza e bërë planit mësimor të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, konfirmojmë se plani mësimor është hartuar duke u bazuar në VKM Nr.41, date 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar; Urdhrin e MASR Nr. 821, date 26.12.2018 “Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve, si dhe në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS)</p> <p>Veprimtaritë formuese pjesë e këtij plani mësimor ABCDE janë konform udhëzimeve të MARS dhe përafësisht me përqindjet që kërkohen sipas këtyre udhëzimeve.¹⁹</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në analizën e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve, rezultojnë se struktura e ndërtimit dhe përmbajtja e tij qëllimi dhe objektivat, realizojnë formimin e shprehive të veçanta si në fushën e muzikës ashtu edhe në fushën e mësimdhënies. Në planin mësimor²⁰ lëndë të përfshira në veprimtaritë formuese B mundësojnë përvetësimin nga studentët si përvetësimin e teorive dhe parimeve akademike në fushën e muzikës ashtu edhe formimin e tyre me mjeshterinë e ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e stileve muzikore. Si edhe u verifikua nga vizita në institucionin numri i të punësuarve mbi 90 % të diplomuarve konfirmon se studentët e diplomuar kanë aftësitë dhe kompetenca për tu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Nga ana tjetër një analizë e syllabusve të veprimtarisë formuese A tregon se këto veprimtari japin mundësi studentëve të marrin njohuri dhe të formojnë shprehje dhe kompetenca në aspektin profesional në fushën e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga verifikimi i programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve rezultojnë se ky program është realizuar konform udhëzimeve të MAS-së dhe udhëzimeve të vetë institucionit për praktikën profesionale dhe detyrimet mbyllëse. Në planin mësimor²¹ janë planifikuar dy praktika si ajo profesionale për mësimdhënien me 3 javë, dhe praktika artistike me ngarkesën 30/20 gjithsejt të dyja me 8 ECST. Rezultojnë se praktika mësimdhënien bëhet në shkollë sipas marrëveshjeve me ZAV-të ndërsa praktika artistike rezultojnë të bëhet nga përfshirja e studentëve në jetën koncertale të fakultetit të Muzikës.</p>

¹⁹ Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Fagot dhe Mësuesi.

²⁰ Po aty.

²¹ Planet mesimore “Fagot dhe Mësuesi”.

	<p>Ndërsa po në këtë plan detyrimet mbyllëse janë përcaktuar me një ngarkesë 2 orë në javë dhe 520 orë punë individuale të studentit me 22 ECTS.</p> <p>Gjatë vizitës në takimin me stafin dhe studentë u konfirmua se në semestrin e 4-tërt ngarkesa 2 orë në javë në auditor është edhe një mundësi takimi më udhëheqësin si dhe për të kontrolluar ecurinë e punës së studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga analiza e programeve të studimit të nivelit bachelor në Fagot me programin Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", mund të konfirmojmë se ka një vazhdimësi si nga ana strukturore por edhe në përmbajtje duke u bazuar si në qëllimet ashtu edhe objektivat e këtyre planeve. Dizenuar si Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" ai është në përputhje me ligjin 80/2015²² dhe udhëzimet e MAS-së, duke synuar formimin shkencor dhe profesional të studentëve si si artistë dhe si mësues.</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve në planin mësimor rezulton se Programi i studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" është i organizuar sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe shtojcës 1 të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit te ofruara nga IA.L e ndryshuar. Ky program është më një kohzgjatje dy vite dhe ka 120 kredite . Veprimtaritë formuese A (Lëndë bazë -përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) përbëjnë 24 ECTS por duke marrë si formim profesional edhe praktikën me 6 ECTS, bëhen gjithsejt 30 ECTS, duke plotësuar 25% të krediteve të kërkuara për këto programe studimi që përgatisin edhe mësues.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga grupi i vlerësimit të brëndëshëm rezulton se forma e organizimit të programit të studimit është me kohë të plotë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75.pika 4) statutit të Univeritetit të Arteve²³, si dhe rregullores se studimeve të këtij programi. Pranimi i studentëve bëhet me konkurs bazuar në rregulloren e programit të studimeve (neni 11), në kriteret e përcaktuara e të miratuara nga Fakulteti i Muzikës (shkresa Nr. 20/2. date 21.01.2022), në përputhje me nenin 76.pika 1;2;3, të ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe nenit 92 të statutit të institucionit.Rezulton se ka një rregullore të miratuar nga fakulteti dhe Senati për realizimin dhe procedurat e zhvillimit të konkursit të pranimit, dhe se kjo rregullore dhe procedurat publikohen në faqen zyrtare të UART-ve</p> <p>Rezulton se financimi i këtij programi studimi bëhet nga Departamenti i Interpretimit në përputhje me Statutit e institucionit (Neni 92/7), edhe VKM 780 datë 26.12.2018.²⁴</p>

²² Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë

²³ Statuti i Universitetit Të Arteve

²⁴ Statuti i Universitetit Të Arteve.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i Studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” rezulton se ofrohet vetëm në Departamentin e Interpretimit të Fakulteti i Muzikës të Universiteti të Arteve. Në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 ai është i ngjashëm me të gjithë Masterat e Arteve në Mësuesi që ofron kjo njësi duke përmbushur mbi 90% të programit të njëjtë sic kërkohet për mastera në të njëjtën fushë studimi, që ofron ky departament.						
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga shqyrtimi i programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” rezulton se ky program shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga MAS. Programi përfshihet në fushën e studimit Arte dhe Shkencave Humane (kodi 02), si fushë e përgjithshme Arte (kodi 021) dhe fusha specifike Muzike dhe arte performuese (kodi 0215).						
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, nuk ofrohet si program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.						
Konkluzione	<i>Lidhur me këtë standart, GVJ mendon se, programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është tërësisht në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75.pika 4), Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe rregullores se studimeve të këtij programi.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standarti II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Bazuar në verifikimin e dokumentacionit, konfirmojmë se njësia kryesore bazë për programin e studimit Masteri Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, Fakulteti i Muzikës funksionon konform legjislacionit në fuqi. Fakulteti i Muzikes ka në përbërje të vet 3 Departamente: Departamentin e Interpretimit, Departamentin e Kompozicionit, dhe Departamentin e Kantos, duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në Ligjin 80/2015, Neni 23/2. Departamenti i Interpretimit si njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi është konform ligjit. ^{25, 26}
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në	Nga verifikimi i të dhënave në RVB dhe në takimin me drejtues të fakultetit, departamentit si dhe me Drejtorinë e Burimeve njerëzore rezulton se njësia bazë e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot

²⁵ Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë.

²⁶ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, , Universiteti i Arteve, 2021-2022.

<p>fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>dhe Mësuesi”, angazhon personel ndihmës akademik dhe administrative për realizimin e këtij programi. Angazhimi i personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore bëhet me urdhër të brendshëm sipas rregullores së brendshme të institucionit. Deklarimet e bëra nga grupi i punës i RVB-së si Urdher i brendshëm për angazhimin e personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore;Skeda e studentit praktikant; Marreveshja e praktikës; Formulari i vlerësimit për studentin u verifikuan gjatë vizitës.²⁷</p> <p>Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit. Institucioni ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore dhe mirëmban pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës.Numri I punonjësve ndihmës për laboratorët dhe teknikës është 7 dhe janë të diplomuar në profilin e studimeve që ofron universiteti.²⁸</p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Konfirmojmë se ka një program lënde për praktikën artistike dhe mësimdhënies pra rezulton se njësia përgjegjëse e këtij programi studimi ka caktuar nga një përgjegjës për realizimin e tyre.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ka një personel të mjaftueshëm ndihmës si akademik dhe administrativ të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit, dhe ka organizuar praktikën si artistike ashtu edhe mësimore në përputhje me rregulloret e institucionit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe</p>	<p>Rezultoni se, nga verifikimi i dokumentacionit që disponon njësia kryesore e programit të studimit, Fakulteti i Muzikës ka tërë informacionin e nevojshëm si për organizimin e programit ashtu edhe për strukturën dhe përmbajtjen e tij. Fakulteti disponon të gjitha vendimet e marra nga Senati për organizimin e këtij programi, rregulloren e studimit të këtij program</p>

²⁷ Planifikimi i personelit të FM nga DI.

²⁸ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, , Universiteti i Arteve, 2021-2022.

përmbajtjen e programit të studimit.	ku përcaktohen në detaje struktura, dhe përmbajtja, rregullorja e pranimit me kriteret dhe procedurat e realizimit të konkursit, etj. Në RVB të gjithë këto dokumenta janë pasqyruar me evidenca, por janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UART-së.						
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Konfirmojmë se pjesë e këtij programi të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është edhe plani mësimor i detajuar sipas udhëzimeve të MAS-së dhe të rregulloreve të miratuara për këtë program studimi. Në planin mësimor ndarja e lëndëve është bërë sipas të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IA.L e ndryshuar. Janë të pasqyruara ngarkesa e lëndëve, raporti brenda dhe jashtë auditorit, pikët kredite etj.						
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e studimit të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” të miratuar në Senatin Akademik me vendimin Nr.58 datë 13.09.2022, si dhe rregullorja e konkursit të pranimit Nr.20/1 datë 02.01.2022, rezulton se ka tërë informacionin e nevojshëm lidhur me pranimin e studentëve (neni 12), transferimin e tyre (neni 24) . Në vizitën në institucion në takimin me sekretarinë mësimore dhe me studentë u konfirmua se në rregulloren e këtij programi studimi të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të fakultetit, studentët marrin tërë informacionin e plotë lidhur me konkurset e pranimit ashtu edhe ekuivalentimin e studimeve (në rastet e mobiliteteve të studenteve në kuadrin e projekteve Erasmus) apo edhe transferimin e studimeve, ndonëse nuk ka asnjë transferim.						
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Departamenti i Interpretimit si përgjegjës i realizimit të këtij programi studimi zotëron të programet lëndore syllabuset pjesë e planit mësimor të programit të hartuara sipas udhëzimeve dhe rregullores së këtij program studimi, si elementet e kërkuar sipas VKM Nr. 41 date 24.01.2018 i ndryshuar dhe formatit të miratuar në nivel institucioni.						
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Ndonëse ka një analizë që bëhet për realizimin dhe cilësinë e programi të studimit Master I Arteve në “ Fagot dhe Mësuesi” nga njësi bazë dhe komisioni i ngritur për sigurimin e cilësisë, të miratuar nga Rektori dhe të dërguar më pas njësisë përgjegjëse, nuk ka patur asnjë ndryshim në këtë program.						
Konkluzione	<i>Mendojmë se Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është i organizuar dhe strukturuar në përputhje me objektivat formuese të një programi të nivelit të dytë, duke përmbushur të gjitha kriteret që kërkohen.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur rezulton se programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” i ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme por edhe punësimin e tyre. Gërshtëtimi i lëndëve pedagogjike më ato artistike ndihmon në aftësimin e zhvillimin e tyre profesional për punësimin e tyre të ardhshëm. Ky program studimi është një vijim i thelluar i njohurive të marra në nivelin e parë të studimit Bachelor por duke patur si risi ofrimin për studentë të mundësinë të marrin informacion në fushën didaktike e praktike të mësimdhënies.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkitimit shkencor.	Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është strukturuar në veprimtari formuese A;B;C;D;E. që realizohen në një shtrirje kohore 2 vjecare me 4 semestra me 120 kredite (ECTS) Vlerësimi i punës së studentëve është 25 ore për një kredit dhe nënkupton si vlerësimi i punës në auditor ashtu edhe punën e pavarur të tyre jashtë auditorit. Mendojmë se ky strukturim i planit mësimor mundëson realizimin e objektivave të këtij programi, si dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Rezultoni se struktura e programit, plani mësimor si pjesë e tij, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe bazuar edhe në eksperinca ndërkombëtare. Planin mësimor i programit ²⁹ ka dhënë shumë përparësi ushtrimeve apo seminareve në raportin teori praktikë, duke synuar zhvillimin e karrierës artistike të studentëve si dhe aftësimin në mësimdhënie për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Këtë e mundëson përfshirja në planin mësimor i lëndëve tërësisht të lidhura me psikologjinë dhe mësimdhënien.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duke analizuar planin mësimor të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” në aspektin e raporteve mes lëndëve të shtrira sipas veprimtarive formuese dhe raportin teori praktikë brenda vetë lëndëve të një tipi veprimtarie, rezultoni se ai i krijon mundësi studentëve jo vetëm që të kenë hapësira më të mëdha punësimi por edhe mundësinë për njohjen dhe transferimin e studimeve dhe realizimin e mobiliteteve në universitete homologe jashtë vendit.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën	Duke patur parasysh natyrën dhe statusin e vecantë të programeve që ofron, shprehemi se, në përgjithësi, programet lëndore zhvillojnë kompetencat e nevojshme të studentëve duke pasqyruar edhe kërkesat e tregut të punës. Në shqyrtimin e programeve lëndore gjatë tre viteve rezultoni se ka një përditësim të literaturës bazë dhe ndihmese.

²⁹ Plane mesimore “Fagot dhe Mësuesi”.

bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.									
Kriteri 6. Përbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga analiza e përbajtjes së programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” mund të konfirmojmë se mundëson formimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara në këtë program. Fakti që studentët janë pjesëmarrës në koncerte dhe janë pothuajse tërësisht të punësuar si edhe u verifikua nga vizita në institucion, e konfirmon këtë gjë. ³⁰								
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Rezulton se përbajtja e Programit të Studimit Master I Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” i jep mundësinë studentëve që janë diplomuar për të vazhduar studimet në nivelin e tretë të studimeve për doktoraturë. Ne nenin 69 të rregullores së studimit të Universitetit të Arteve theksohet se në studimet doktorale te nivelit të tretë mund të vazhdojnë edhe studentët që kanë fituar një diplomë në Master i Arteve.								
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se struktura dhe përbajtja e programit të studimeve Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe objektivave të programit, duke garantuar formimin e kompetencave si artistike dhe mësimdhënëse në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Punësimi i të diplomuarve mbi 90% verifikuar gjatë vizitës e konfirmon këtë. Nga shqyrtimi i programeve lëndorë vumë re që ka përditësim të literaturës bazë dhe ndihmëse.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me programin Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, rezulton se ky program është hartuar bazuar në urdhërin Nr. 616 datë 30.12.2016 dhe Nr. 821 datë 26.12.2018 i MAS-se për verifikimin e përshtatshmërisë të programeve të studimit të ciklit të dytë në fakultete të Universitetit të Arteve si dhe të vendimit të hapjes së këtij programi. Nga verifikimi i dokumentacionit mund të konstatohet se është bërë një punë e mirë për hartimin e tij duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë si institucione homologe, të diplomuar, përfaqësues të institucioneve arsimore etj.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe	Gjatë vizitës u konfirmua se Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe

³⁰ Raporti i Vlerësimit të Brendëshme 2021-2022, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve

strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Mësuesi”, realizon një feedback me studentët dhe strukturat e tyre, mban dhe merr sugjerime nga studentët e diplomuar, shfrytëzon projektet e përbashkëta që ka me partnerë të huaj, me synimin për përmirësimin e programit të studimit.								
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	FM dhe DI ku oftohet programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, deklarohet se konsideron proces të përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjes së programit të studimit, propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, bashkëpunimin me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione, përvojën akademike të fituar si dhe shkëmbimet të personelit akademik në kuadër të mobiliteteve ERASMUS+ KA 107 ³¹ , ³² , organizimit të Master classeve. Por GVJ mendon se nuk rezulton se ka ndonjë ndryshim apo përshtatje të këtij programi, pasi ka pak vite që është hapur dhe rezultatet dhe objektivat janë arritur.								
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se njësia përgjegjëse organizon një sërë bashkëpunimesh dhe veprimtarish që synojnë përmirësimin e programit të studimit me një sërë aktorësh profesionistë të fushës, me pjesëmarrje në projekte me partnerë të huaj, por nuk rezulton se ka ndonjë ndryshim të këtij programi, pasi është arritur qëllimi dhe objektivat e programit.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe në analizën e programeve të lëndëve të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, rezulton se janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat e Universitetit të arteve, Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit. Përmbajtja e lëndëve dhe strukturimi i tyre janë në funksion të formimit të studentëve me bazat didaktike, muzikore dhe kulturore të koncertimit në fagot, rritjes së mjeshtërisë të ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e stileve muzikore, aftësimi të tyre në mësimdhënie për të gjithë sistemin arsimor.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke	Nga takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të njësive kryesore dhe njësive bazë si dhe me stafin akademik rezulton se ka një bashkërendim të tërë strukturave të angazhuara në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” (të Sekretarisë mësimore, Sektorit mësimor dhe të kurikulës, Burimet

³¹ Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020

³² Raporti i Vlerësimit të Brendëshme 2021-2022, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve

respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	njerëzore, Zyra e projekteve ³³ , Zyra e informacionit protokoll /arkivës ³⁴) dhe orientim e mbështetje për veprimtaritë artistike dhe shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit të përfshirë në këtë program.						
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga një analizë e veprimtarive të organizuara nga Fakulteti I Mësuesisë dhe Departamenti i Interpretimit rezulton se në Programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" studentët angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si nepërmjet detyrimeve që kanë gjatë vitit në lëndë të ndryshme por edhe nga pjesëmarrjes në aktivitetet artistike dhe kërkimore artistike që organizohen në DI apo dhe të FM-së. Konstatohet se studentët me të dalluar përzgjidhen dhe angazhohen në projekte bashkëpunimi me Orkestrën e TKOBAP, në Master Classet apo te sektorit jopublik, përmes OJF në fushën e muzikës.						
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetjet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga shqyrtimi i buxhetit të Universitetit rezulton se Fakulteti I Muzikës me miratimin e Bordit të Administrimit të UART ka mbështetur Departamentin e Interpretimit në kuadër të pajisjes me instrumente muzikore të tipologjive të apo edhe në aktivitetet kërkimore/artistike të festimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës me dhënien e ambienteve të UART-së falas dhe mbulimin e materialeve logjistike dhe komunikimit. Një ndihmesë e madhe për stafin akademik kanë qënë edhe mbështetja financiare nga projektet apo edhe nga organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerë të huaj në kuadrin e këtyre projekteve.						
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se programi Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" ka përcaktuar prioritetet objektivat dhe qëllimet në aspektin e studimit dhe të kërkimit shkencor. Realizimi i tyre bëhet bazur në një bashkëpunim të efektshëm të tërë njësisve të UART-së dhe Fakultetit të Muzikës, duke përfshirë dhe nxitur aktivisht studentët në këtë proces.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" rezulton se operon në koordinim me grupet lëndore që janë pjesë e strukturës së saj për realizimin e objektivave të programit të studimit që lidhen me kërkimin shkencor. Rezultoni se njësi kryesore përgjegjëse për realizimin e programit, për vetë natyrën specifike që ka institucioni, ka mbështetur grupet mësimore

³³ Raporti i Zyrës së Projekteve, upload në llogari të ekspertëve, nga ASCAL

³⁴ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022.

	<p>në projekte shkencore dhe përfshirjen e të rinjve në projekte dhe produkte artistike e kerkimore në fushën e muzikes bashkëkohore.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me një sërë veprimtarish artistike që ka organizuar njësisia me rrastin e 60 vjetorit të UART ku u theksuar se janë realizuar 60 ditë koncerte tërësisht me stafin dhe studentë të këtij institucioni, si dhe veprimtari të tjera artistike në bashkëpunim me pedagog të huaj edhe në kuadrin e Master Classeve.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, DI, si pjesë e FM-së së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" rezulton se aktualisht është e angazhuar nepërmjet strukturave të saj në projekte kërkimore, si në kuadër të financimeve të huaja apo vendase, ashtu edhe në veprimtari me natyrë ekspertize të kërkuara nga institucione të ndryshme në vend, (personeli akademik pjesëmarrëse në juri në Tiranë, Shkoder, Elbasan dhe Gjirokastër).</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>DI, si pjesë e FM-së së Universitetit të Arteve ku ofrohet program i studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", në përputhje me statusin që ka, konfirmojmë se ka organizuar një sërë aktivitete artistike shkencore, që lidhen me realizimin e objektivave të syllbuseve të këtij programi si pjesmarrje në koncerte, festivale, konkurime, etj.</p> <p>Rezulton se ky departament është pjesë integrale edhe e një sërë projektsh shkencore me partnerë evropianë në kuadrin e të cilëve ka organizuar dhe ka marrë pjesë në koncerte, takime dhe konferenca shkencore.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Gjatë vizitës u konfirmua nga dokumentacioni I verifikuar, angazhimi e një numri studentësh në institucione artistike në vend gjatë viteve 2019-2022 (6 studentë punësuar në shkollat e mesme artistike; orkestrën e forcave të armatosura) apo pjesmarrje në audicione për pozicione në orkestrat e të rinjve të krijuara në kuadër të nismave rajonale si CEMAN (Central European Music Academies Network,) gjë e cila tregon se në këtë program është punuar mirë për formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e punës si brënda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Duke analizuar strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" objektivat e tij për formim të studentëve si në aspektin artistik por edhe mësimdhënës mund të konkludojmë se Departamenti i Interpretimit përgjegjës për këtë program studimi ka marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet nga MAS ³⁵, (Udhëzimi nr.100 datë 25.02.2022) institucioneve të tjera, kërkesave të tregut të punës, lidhur me e studentëve të tyre me mundësinë për licensimin në profesionin e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional</p>	<p>Rezulton se program i studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS ³⁶ për profesionet e rregulluara ku përfshihet edhe mësuesia si pjesë e formimit të studentëve të këtij programi (Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara),.</p>

³⁵ Udhëzimi nr.100 datë 25.02.2022

³⁶ MAS Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara.

Qualifications Directive, 2005/36/EU).							
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se Programi i studimit Maser i arteve në "Fagot dhe Mësuesi" bashkërendon veprimtaritë e tërë strukturave të saj për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe veprimtarisë artistike dhe shkencore, me një pjesmarrje dinjitoze me partnerë ndërkombëtarë, me një angazhim të studentëve cilësor në këto veprimtari. Ajo ka zbatuar të gjitha aktet ligjore lidhur me kërkesat që lidhen për profesionin e rregulluar në fushën e mësuesisë.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rezulton se Universiteti i Arteve ka përcaktuar nepërmjet një sërë dokumentash të miratuara format e mësimdhënies me të cilat realizohet procesi mësimor. Këto forma të mësimdhënies janë të përcaktuara në nenin 34 – Mësimdhënia, e Rregullores së Fakultetit të Muzikës; si dhe në programet e lëndëve. Edhe praktika profesionale është organizuar dhe zbatuar, bazuar në urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.1305 datë 25.02 2022 për rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, dhe rregullore e studimit të programit Masteri Arteve. ³⁷
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Duke shqyrtuar dokumentacionin e departamentit që zbatohet për mësimdhënien, lidhur me programet e studimit të nivelit të dytë si dhe nga një analizë e syllabuseve të programit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", mund të konstatojmë se personeli akademik që është përfshirë në realizimin e këtij programi përdor forma dhe metoda mësimdhënëse në përputhje me natyrën e programit dhe të mundësive të studentëve.

³⁷ Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte (Fagot dhe Mësuesi).

	<p>Për specifikën që ka institucioni format e mësimdhënies janë në përputhje me këtë specifikë si leksione speciale individuale, saxho, mësim ansambël në grup, ushtrime etj.</p> <p>Në një shqyrtim të syllabuseve rezultojnë se zbatohen edhe forma të tjera si punime individuale, esse dhe detyra, koncerte etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve dhe Fakulteti i Muzikës rezultojnë se mbështet pedagogët për kualifikimin e tyre si në aspektin artistik ashtu edhe didaktik duke krijuar mundësi si në shfrytëzimin e infrastrukturës së institucionit ashtu edhe në pjesëmarrjen e tyre në projektet e ERASMUS+ në veprimtari me karakter didaktik. Kjo drejtë dhe detyrim i personelit për trainim dhe kualifikim është pasqyruar edhe në Statutin e UART neni 68 “ Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik”</p> <p>Një aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të kompetencave didaktike është edhe pjesëmarrja në Master classe dhe koncerte të cilat rezultojnë se janë të shumta në këtë institucion.³⁸</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe CV-ve të stafit akademik³⁹ të përfshirë në këtë program studimi rezultojnë se pedagogët që japin mësim në këtë program janë personalitete të njohura në fushën e artit me një eksperiencë shumëvjeçare si në aspektin artistik ashtu edhe në mësimdhënie. Për vitin akademik 2021-2022 nga 17 pedagog PAE të përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit, 7 janë me titullin Profesor; 4 Prof. asociuar; 2 me titullin Doktor dhe 4 Asistent lektor, ndërsa staf PAK i këtij programi janë 3 pedagogë nga të cilët 2 me titull Doktor dhe 1 Asistent lektor.</p> <p>Po ashtu rezultojnë se edhe pedagogët që mbulojnë lëndët didaktike kanë kualifikim të duhur sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.</p> <p>Nga analiza e syllabuseve kupton se stafi akademik përdor forma të larmishme mësimdhënie bashkëpunuese duke integruar studentët në procesin mësimor dhe ruajtur marrëdhënie korrekte me to. Pjesëmarrja e studentëve së bashku me stafin në koncerte apo veprimtari artistike janë një pasqyrë e mirë e këtyre marrëdhënieve, dhe e zbatimit të kodit të etikës që funksionon në këtë institucion.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në dokumentacionin e Fakultetit të Muzikës dhe në Departamentin e Interpretimit janë përcatuar detyrimet e pedagogëve për një mbarëvajtje të procesit mësimor (Neni 28, pika 14;16;17; i rregullores së Departamentit të Muzikës si dhe Neni 14 i Rregullores së studimit të programit) ashtu edhe format dhe mënyrat e vlerësimit të mësimdhënies së stafit akademik në analizat vjetore dhe pyetorët me studentë.</p> <p>Nga takimi me studentë rezultojnë se departamenti jo vetëm që ka përfshirë studentët në këtë proces, por edhe ka reflektuar ndaj sugjerimeve të tyre. Studentët e vitit të dytë të studimeve deklaruan se ka patur një rast të tillë kur është marrë në konsideratë sugjerimi i tyre për të ndryshuar në planin mësimor nga simestrale në shtrirje vjetore ngarkesën e lëndës Histori muzike dhe Histori e estetikës muzikore.</p>

³⁸ ERASMUS statistika, Rregullorja e Departamentit të Muzikës - neni 28. pika 14;16; 17

³⁹ Profili i stafit akademik, CV, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve, www.uart.edu.al

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Fakultetin e Muzikës dhe verifikimit gjatë vizitës në këtë fakultet rezulton se janë ngritur struktura apo njësi të cilat ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies, nepërmjet kordinimit të veprimtarisë së tyre si grupet mësimore, sekretaria mësimore dhe komisioni që është ngritur për sigurimi e cilësisë. Përdorimi i masterclasseve si forme shkembimi të eksperiencave mësimdhënëse, mes stafit akademik dhe pedagogëve të huaj të ftuar është një formë e rëndësishme që ndihmon në zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja inovative. Në takimin me drejtuesin e zyrës së projekteve u konstatua se pjesmarrja në projekte me universitete homologe jashtë vendit rezulton si një mundësi trainimi për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konfirmon se institucioni ka sanksionuar me rregullore forma të larmishme mësimdhënie në përputhje me specifikën e tyre si institucion artistik, për një proces të nxëni dhe aftësim profesional e shkencor të studentëve, duke integruar dhe nxitur studentët në këtë proces.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit të Interpretimit kreu V nenet 29;30;31;32 janë përcaktuar qartë mënyrat format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve të të gjitha programeve të studimit. Mënyra e vlerësimit kriteret parakushtet për të hyrë në provim, sezonet e kontrollit të dijës janë të përcaktuara edhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Fagot dhe Mësuesi , si dhe syllabuseve të programit. Këto rregullore janë të publikuara në faqen zyrtare të UART-së.⁴⁰</p> <p>Njohja e studentëve me rezultatet e vlerësimit të tyre bëhet nepërmjet sistemit të menaxhimit të vlerësimit të studentëve (ESSE3) aktualisht sistemi PITAGOR.A, përmes të cilit, jo vetëm dokumentohen testimet dhe vlerësimet e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve të program të studimit Master i Arteve ne “Fagot dhe Mësuesi” por edhe mundësohet komunikimi i drejtperdrejtë me studentet fagotistë, lidhur me vendosjen e rezultateve në databazen e UART.</p>

⁴⁰ www.uart.edu.al

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve sipas rregullores së UART ⁴¹ obligon pedagogët ta bëjnë prezent para studentëve në orën e parë të mësimin të gjitha format dhe kriteret e vlerësimit. Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentë u konfirmua se ato njihen me përmbajtjen e lëndës dhe me format e vlerësimit në orën e parë të mësimin.</p> <p>Në sekretarinë mësimore na u komunikua se po punohet për të digjitalizuar edhe syllabuset me qëllimin që studentët të kenë akses online dhe të njihen si me përmbajtjen e lëndëve por edhe me format e vlerësimit të tyre.</p>								
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Duke ju referuar rregullores së studimit të Departamentit të Interpretimit si dhe rregullores së studimit të programit të studimit të nivelit të dytë neni 20 rezulton se përdoren një tërësi formash testimi dhe vlerësimi, dhe ka një sistem vjetor vlerësimi. Rezulton nga studentët se vlerësimi i tyre është një sistem që përmban edhe vlerësimin e performancës së tyre gjatë vitit dhe vlerësim të njohurive teorike. Këtë mënyrë vlerësimi u konstatua gjatë vizitës se behej edhe në mbrojtjen e diplomës, ku studenti përveç performancës me instrument, paraqiste edhe një mikrotezë, ku trajtohej teorikisht pjesa që ai luante me instrument.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është i mendimit se në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" stafi akademik përdor konform rregulloreve të miratuara forma të larmishme mësimdhënie dhe kontrolli në përputhje me specifikën e natyrën e institucionit. Rezultatet e arritura në aftësimin artistik të studentëve e konfirmojnë këtë gjë. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Departamentit të Interpretimit dhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Fagot dhe Mësuesi rezulton se janë përcaktuar qartë që vlerësimi përfundimtar reflekton rezultatit integral të të gjithë vitit sipas syllabusit të lëndës respektive dhe duhet të reflektohet në vlerësimin përfundimtar..</p> <p>Periodha kohore e marrë në shqyrtim shtrihet në të gjithë vitin akademik dhe çdo lëndë ka mënyrën e vet specifike të vlerësimit dhe raporte të ndryshme të elementëve që janë fleta e provimit dhe procesverbali i vlerësimit.⁴²</p>

⁴¹ Rregullorja e UART , neni 78

⁴² Neni 21 i Rregullores së studimit Master i Arteve.

	Në takimin me studentë dhe stafin akademik të programit të studimit u konstatua se gjatë tërë vitit ngrihet një komision i cili verifikon format dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve. Studentët deklaruan se vlerësimi i tyre shtrihet gjatë tërë vitit si për performancën e tyre në instrument por edhe më provime dhe kolegjume në pjesën teorike të programit të lëndës.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për lëndët profesionale artistike vlerësimi bëhet me interpretim muzikor në kohë reale dhe me praninë e publikut, duke shmangur në këtë mënyrë ndonjë formë abuzimi dhe subjektivizmi në vlerësim. Për lëndët teorike u verifikua se përdoren sekretimi i fletës së provimit, që jep mundësi të ketë objektivitet në vlerësim.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga vizita e zhvilluar në sekretarinë mësimore u verifikua se vlerësimet e studenteve bëheshin konform kriterëve të përcaktuara në Syllabuset lëndore. Po ashtu, nga verifikimi i Syllabuseve ⁴³ u vu re që ata kishin të përcaktuar qartë mënyrat dhe format e vlerësimit,. Ky fakt u konfirmua edhe në takimin me studentë.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në bisedën e zhvilluar me studentë të programit të studimit, konfirmojmë se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet edhe me komente e diskutime të hapura përpara të gjithë grupit të studentëve dhe lidhet me këshilla të vlefshme nga artistet e afirmuar të personelin pedagogjik akademik mbi procesin e të nxënës dhe ndihmon për të projektuar punën në të ardhmen. Duke u nisur nga natyra e lëndëve dhe forma e vlerësimit që ka në themel performancën e studentit në instrument dhe që realizohet gjatë tërë vitit në orët e punës individuale me to, studentët deklaruan se feedbacku i pedagogut është gjithmonë i pranishëm dhe i ndihmon të përmirësohen në performancën e tyre me instrumentin.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në dokumentacionin që zotëron njësia përgjegjëse e programit të studimit janë të përcaktuara qartë procedurat e realizimit të provimeve për të shmangur kopjimin apo plagjiaturat. Në provimet teorike zbatimi i elementëve të tillë si identifikimin e studentit nëpërmjet një dokumenti zyrtar (id,pasaportë et/), ndalimin e aparaturave të teknologjisë, të cilat nuk janë pjesë e zhvillimit të provimit (telefon, etj), ndalimin e pranisë së personave që nuk kane lidhje me testimin, sekretimin e provimin me shkrim për të ruajtur anonimatit e studentit dhe vlerësimet subjektive të mundshme, janë pasqyruar në rregullore të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve. ⁴⁴ Takimi cdo javë me pedagogun udhëheqës gjatë përgatitjes së diplomës deklarohet nga drejtuesit e njësive se është një formë e mirë për të shmangur plagjiaturën.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga verifikimi i formave dhe procedurave të vlerësimit rezulton se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe realizohen mbi bazën e meritës sipas specifikimeve respektive të rregullores së studimeve dhe vlerësimit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës së syllabusit të programit mësimor. Per me

⁴³ Syllabueset "Fagot dhe Mesuesi".

⁴⁴ Neni 20, pika 8,9,10 e Rregullores së studimit Master i Arteve

	tepër, ballafaqimi i vazhdueshëm me publikun dhe komisionet e audicioneve apo konkurseve të ndryshme, i bejne të paiteruesar si studentin, ashtu edhe pedagogun që të vendose rezultat të pabazuar në meritë.						
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga rishikimi i dokumentacionit rezulton se në nenin 20 pika 13;14 të rregullores të studimit të ciklit të dytë Master I Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për njohjen e studentit me vlerësimin dhe garantohet e drejta e studentit për raste kur ka kontestim të vlerësimit. Në takimin me studentë u konfirmua nga ata se nëpërmjet platformës Pitagora dhe me E- Mail merrnin në kohë vlerësimin e anës teorike të provimit të kryer, si dhe i njihnin mirë procedurat e rishikimit të vlerësimit, anikimin, ngritjen e një komisioni të ri vlerësimi, ndonëse nuk kishte patur ndonjë rast të tillë. ⁴⁵						
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në nenin 20 pika 17 të rregullores të studimit të ciklit të dytë Master I Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për rastet kur ka ankimin lidhur me vlerësimin e studenteve. Në këtë rregullore janë pasqyruar të gjitha të drejtat e Dekanit të Fakultetit për anulimin e vlerësimit të bërë dhe ngritjen e komisionit të ri të rivlerësimit të studentit. Nga vizita rezultoi se nuk ka patur asnjë kërkesë për ankimim nga ana e studentëve në këtë program.						
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni përdor forma dhe procedura të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nëpërmjet platformës Pitagora dhe performancës para publikut për lëndët artistike. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Duke bërë një analizë të strukturës dhe përmbajtjes të dy planeve mësimore atij të nivelit bachelor dhe master i arteve rezulton se programi i studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" jo vetëm që është një vazhdimësi logjike me programin bachelor në aspektin e realizimit të synimeve dhe objektivave të tij, por edhe synon thellimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësimin e tyre profesional. Strukturimi i këtij programi jep mundësi studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe artistike në një qasje ndërdisiplinore por edhe krijimin e mundësive për tregun e punës së edhe si specialist i artit dhe si mësues.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Në programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" rezulton se ka një lëndë (Informatike e aplikuar) e cila ka si objektiv të saj zhvillimin e aftësive teknologjike në shërbim të profesionit të tyre. Si

⁴⁵Rregullorja e Studimeve të ciklit të Dytë Master, Faqja Zyrtare online, ëëë.uart.edu.al,

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).</p>	<p>edhe konstatohet nga qëllimi i lëndës studenti aftësohet për realizimin e një projekti individual dhe të pavarur rregjistrimi, masterizimi dhe realizimi në CD audio të përformancës së tyre solistike.</p> <p>Rregullorja programit të studimit Master i Arteve, përcakton qartë që studenti që rregjistrohet në këtë program studimi duhet të zotërojë një nga 5 gjuhët e huaja të Bashimit Europian gjë e cila zbatohet për këtë program.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se ka një feedback lidhur me rezultatet e arritura nga studentët sidomos në lëndët artistike, ku vihen në dukje sidomos mangësitë që shërbejnë për përmisimin e performancës në instrument.</p> <p>Në disa lëndë u tha nga stafi akademik në takim për vetë natyrën e tyre ka 2 ose 3 titullarë që firmosin, ndaj cdo sugjerim që vjen nga studentët pasqyrohet në programin e lëndës. Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët në rastin e lëndës Histori e Muzikës dhe Histori e Estetikës muzikore.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve⁴⁶ rezultojnë se ka një përqindje të madhe të karakterit praktik, apo zbatimit të metodave dhe aktiviteteve nga pedagogët në klasë, duke krijuar klimën e përshtatshme për pjesëmarrje të studentëve dhe mbështetjen e ideve inovative.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën e fakultetit si Fakultet i Muzikës, orët e hapura e seminarët për zhvillimet e reja të shkencës (muzikës) rezultojnë se janë të lidhura me veprimtaritë e organizuara jashtë auditorit si koncerte apo evente koncertale etj. Me rastin e 60 vjetorit të UARIT u organizuar 60 ditë koncerte jashtë procesit mësimor⁴⁷.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të fakultetit dhe me studentë rezultojnë se institucioni konsideron si ide inovative, evoluimin e gjuhës, mjeteve shprehëse të krijimtarisë dhe interpretimit bashkëkohor si dhe interpretimin e veprave të reja premiere të muzikës bashkëkohore, por nuk rezultojnë të ketë mbështetje direkte financiare. Ato mbështeten me dhënie të drejtës për të përdorur sallat për koncerte apo veprimtari si dhe për logjistikën e veprimtarive.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se përfshirja e studentëve në veprimtarinë artistike (koncerte apo evente koncertale) mobilitetet e tyre të realizuara në</i></p>

⁴⁶ Syllabuse "Fagot dhe Mesuesi".

⁴⁷ Analiza vjetore 2021-2022 e DI-së.

	<p><i>universitete homologe jashtë vendit janë një aspekt i rëndësishëm që garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e studimit Master i Arteve ⁴⁸ janë të përcaktuara të gjitha procedurat lidhur me detyrimet përmbyllëse, si dhe dhënies së diplomës. Këto rregullore janë të publikuara në faqën zyrtare të UART-së.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit UART të rregulloreve të studimit, konfirmohet se janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tërë strukturave si akademike dhe administrative për të mbështetur studentët me informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme që lidhen me detyrimet mbyllëse apo diplomimin. Në planin mësimor të programit është planifikuar në semestrin e fundit edhe një takim i përjavshëm 2 orësh në auditor për të ndjekur ecurinë e punës së studentit dhe për ta ndihmuar atë, gjë e cila u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit. Po kështu rezultoi se në faqen zyrtare të UART-së në rubrikën “Trasparenca” tek procedura informimi dhe ankimim, studenti mund të marrë informacion apo të bëjë kërkesë për të marrë çfarë i nevojitet.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ne rregulloren e programit të studimit Master i Arteve ⁴⁹ publikuar në faqen zyrtare të universitetit, rezultoi se janë të pasqyruara tërë procedurat e punimit dhe të mbrojtjen e diplomës para një komisioni i cili përbëhet nga pedagog me tituj nga departamenti dhe që bëhet publikisht. Edhe nga deklaratimet e studentëve konfirmohet se diplomimi përmban interpretimin e një pjese muzikore dhe mikrotezën një studim lidhur me pjesën që ka interpretuar. Drejtuesit e fakultetit dhe studentët deklaruan se komisioni i ngritur për diplomimin merr në konsideratë tërë ecurinë dhe rezultatet e tyre gjatë dy viteve. Kjo gjë u dokumentua edhe me verifikimin e procesverbalit të provimit të diplomimit pranë sekretarisë mësimore.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e	Në rregulloren e studimit të programit Master i Arteve janë të përcaktuara qartë detyrat e udhëheqësit të diplomës për studentët, grafikun e konsultimeve, afatet e realizimit të punimit, dhe garancinë

⁴⁸ Rregullore e Programit të Studimit Master “Fagot dhe Mësuesi”.

⁴⁹ Po aty.

<p>temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>për cilësinë e punimit. Konstatohet në planin mësimor në semestrin e katërt janë dy orë në javë në auditor që udhëheqësi i përdorte për të kontrolluar ecurinë e punës të studentit dhe për të dhënë udhëzime për përmisim. Në rregullore është përcaktuar edhe detyrimi i njësisë bazë për të kontrolluar ecurinë e kësaj pune. Departamenti disponon dokumente ku mund të verifikohen këto kontrole periodike që ka bërë kjo njësi.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën e institucionit ky kriter nuk zbatohet.</p>		
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në rregulloren e studimeve të programit Master i Arteve, vlerësimi i punimit të diplomës, jepen procedurat e vlerësimit të studentit në punimin e diplomës i ngritur dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit. Rezultoni se vlerësimi bëhet me pikë nga secili anëtarë i komisionit dhe mesatarizimin e pikëve e ben kryetari i komisionit, duke bërë edhe konvertimin e tyre në notë.</p>		
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rezultoni nga dokumentacioni i verifikuar në sekretarinë mësimore se studenti pajiset pas përfundimit të detyrimeve mbyllëse me diplomë dhe suplementin e saj. Nga verifikimi i diplomës rezultoni se diploma ka të gjitha elementët e përcaktuar nga MAS dhe rregullorja e studimit e njësisë kryesore.</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore⁵⁰ rezultoni se në përputhje me ligjin Nr 9887, date 10.03.2008, për mbrojtjen e të dhënave personale , kjo njësi ndihmëse administrative ka dhe ruan për cdo student dokumentacionin përkatës që nga regjistrimi dhe deri në diplomimin e tij, duke e vënë në dispozicion të tyre sa herë i kërkohet.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni zbaton procedure të qarta lidhur me detyrimet përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit ate me dokumentacionin e nevojshëm.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht.</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

⁵⁰ Regjistër themeltar për studentët program model; Të dhëna studentësh.

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga vizita në institucion konfirmojmë se Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit kanë vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi" mjedise të përshtatshme punë dhe logjistike brenda institucionit për realizimin e praktikës artistike të studentëve oboistë. Marrëveshjet me institucionet e arsimit parauniversitar ⁵¹ bën të mundur zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në mjediset e këtyre shkollave, të cilat kanë kushte të përshtatshme për zhvillimin normal të tyre.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Është Master i Arteve ndaj ky kriter nuk zbatohet.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Për vetë natyrën e këtij masteri "Fagot dhe Mësuesi" ka të planifikuar praktikën për mësimdhënie, e cila realizohet në tre javë në shkollë, dhe është vlerësuar me 6 ECTS.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon që Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit planifikojnë sipas procedurave të qarta dhe organizojnë praktikant artistike dhe profesionale për studentët, të cilat realizohen në institucionet e arsimit parauniversitar.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

⁵¹ Marrëveshja me ZVA Vlorë.

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Grupi i RVJ- së gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të RVB-së konstatoi se personeli akademik efektiv dhe me kontratë dhe personeli ndihmës akademik që angazhohen në programin e studimit Master në “Fagot dhe Mësuesi” të ofruar nga Departamenti i Interpretimit në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, i përmbush kërkesat ligjore përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik të stafit, për drejtimin e programit dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit.^{52, 53, 54, 55, 56}</p> <p>Fusha kërkimore e këtij program studimi bazohet në specifikat e moduleve dhe pëcaktohet në dokumentet e Statutit të UART dhe Rregullores së Ciklit të Dytë të Studimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me komizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar evidencave të paraqitura nga DI, konstatoam që realizimi i ngarkesës mësimore për këtë program studimi është në përputhje me bazën ligjore në fuqi.⁵⁷</p> <p>Raporti PAE/PAK për ngarkesën mësimore për tre vite akademike paraqite i tillë:</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, PAE/PAK = 14/1</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, PAE/PAK = 13/4</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, PAE/PAK = 12/5</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar raportit të RVB-së për këtë program studimi, konstatoam se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” ka nënshkruar kontratat me UART sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.⁵⁸ Institucioni paguante rregullisht të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore shëndetësore të stafit akademik.</p> <p>Ne patëm mundësi të shikonim disa nga dosjet e personelit dhe vumë re që Zyra e Burimeve Njerëzore ruante kontratat e punësimit të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në</p>	<p>Bazuar në raportin e RVB-së, UART, FM dhe DI, ku ofrohet ky program studimi, ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi,</p>

⁵² Ligji 80/2015 “Per Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dokumenti I.I.1.1.1.

⁵³ Udhëzim Nr. 29, datë 10.09.2018 “Per veprimtarine dhe ngarkesen mesimore të personelit akademik ne IAL”. Evidenca IV.1.1.2.

⁵⁴ VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 “Per dhenien e statusit të vecantë të Universitetit të Arteve”, Evidenca I.I.1.1.1.

⁵⁵ Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1.

⁵⁶ Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master në Arte “Fagot dhe Mësuesi”, Evidenca 3.

⁵⁷ Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018, Kreu II, Pika 1, 2, 6, 7, 10, 12. Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 dhe 7, Evidenca IV.1.1.8.

⁵⁸ Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1.

<p>kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike. Kriteret e përgjithshme hartoheshin nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërsa ato specifike nga Njësia bazë DI. Të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit bëheshin konform rregullores dhe shpalleshin publikisht në faqen zyrtare të Universitetit.⁵⁹</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UART përcaktonte angazhimin e stafit ndihmës mësimor akademik, si pjesë e njësisë bazë të tij, mbështetur në Statutin e UART.⁶⁰ Funkcionet institucionale të stafit ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike, përcaktoheshin edhe në Rregulloren e FM.⁶¹ Grupi i ekspertëve, gjatë vizitës në institucion, nga bisedat me përfaqësues të DI-së, iu konfirmua se për vetë specifikat që ka Fakulteti i Muzikës dhe DI, si laboratorë shërbenin mjediset që përdorëshin për lëndë individuale ose në grup, ndërsa si laborator standard konsiderohej Laboratori i Audios.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>RVJ evidentoi se UART mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” duke u mbështetur në Statutin e UART (Neni 61, Pika 1, 2). Drejtorja e Burimeve Njerëzore, gjatë vizitës në institucion, na mundësoi të shikonim dosjet e personelit akademik, në të cilat evidentuam se i gjithë dokumentacioni i stafit të brendshëm akademik dhe atij ndihmës dhe administrativ ruhej dhe përditësohej me dokumente të reja nga kjo njësi.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencave të dorëzuara, u konstatua se UART dhe FM kishin lidhur marrëveshje me ZVA Vlorë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve⁶², në të cilin përcaktoheshin detyrimet e FM për ndjekjen e praktikës profesionale të studentëve. Mënyra e vendosjes së personelit të kualifikuar për udhëheqjen e praktikës mësimore përcaktohej në Rregulloren së programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”⁶³. Udhëheqja e punimeve të diplomave dhe e veprimtarive të tjera specifike, përcaktohej në Rregulloren e programit të studimit, Neni 29, Pika 1-7.</p>
<p>Kritër 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>RVJ shprehet se të gjitha detyrimet për angazhimin e personelit pritës të studentëve në institucionet ku do zhvillohet praktika profesionale ishin të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet UART dhe ZVA Vlorë. Sipas kësaj marrëveshjeje, institucioni pritës mernte përsipër: mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë shkollë; caktimin e një mësues mentor të studentit praktikant; vënien në dispozicion të studentëve materialeve dhe mjeteve ndihmëse;</p>

⁵⁹ Ibid. Neni 56 dhe 57.

⁶⁰ Ibid. Neni 69, pika 2 dhe 3.

⁶¹ Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, Neni 7. Evidenca I.1.3.1.12.

⁶² Marrëveshja e FM dhe ZVA Vlorë, Evidenca I.1.3.3.2.

⁶³ Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master në Artë “Fagot dhe Mësuesi”, Neni 28. Evidenca 3.

	angazhimin e studentëve praktikantë; dhënien e mendimeve për vlerësimin e punës së studentëve.		
Konkluzione	GVJ deklaroi se veprimtaria e DI-së dhe aktiviteti i personelit akademik efektiv, ndihmës akademik dhe me kontratë që angazhohet nga Departamenti i Interpretimit, i përmbush kërkimet ligjore në fuqi. Procedurat për rekrutimin e stafit bëheshin konform rregullores dhe shpallehin publikisht në faqen zyrtare të Universitetit. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar vizitës në institucion, vumë re se mjediset për zhvillimin e veprimtarive mësimore ishin të përshtatshme. Për vetë specifikën e zhvillimit të procesit mësimor në FM dhe në këtë program studimi, mësimi i veglës muzikore zhvillohej në raportin një pedagog - një student. Fakulteti i Muzikës vinte në dispozicion gjithë kapacitetet infrastrukturore në funksion të plotë të krijimit të kushteve të duhura si për lëndët muzikore-artistike, ashtu edhe për lëndët pedagogjike.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjetë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga bisedat e qëllimta dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës, pohojmë se për vetë specifikën që kishitë programi i studimit Master “Fagot dhe Mësuesi”, lëndët individuale nuk kishin nevojë për ambiente me pajisje elektronike dhe TIK. Ndërsa për lëndët kolektive vihej në dispozicion Lektoriumi Tonin Harapi, i cili ishte i pajisur me pajisje të TIK-ut. ⁶⁴
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atëlietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar bisedave të qëllimta të zhvilluara me anëtarët e DI dhe vizitës në ambjentet e brendshme të UART, konstatojmë se Studiot e Interpretimit ishin të pajisuara me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kurrikulës së programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”.

⁶⁴ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Fagot dhe Mësuesi”, fq. 90. Evidenca 1.

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita e zhvilluar në ambjentët e brendshme të FM dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar, shprehemi se ky fakultet zotëron në ambientet e tij dy laboratorë të pajisur me kompjutëra dhe programe profesionale. Na u siguroi se laboratori i Tingullit është një studio e mirëfilltë ku realizohej regjistrimi dhe përpunimi audio,⁶⁵ dhe se kompjuterat e laboratorit nr. 1 ishin të pajisur me programin profesional Sibelius (për notizim digjital) dhe Steingerg Cubase (për regjistrim dhe përpunim audio).</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetët që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjektë të tjera (vërtëtuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetët e nevojshme.</p>	<p>Sipas raportit të RVB-së, pohojmë se Fakulteti i Muzikës garanton zhvillimin e praktikave artistike në ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Këto praktika materializoheshin në realizimin e koncerteve, ne te cilat interpretoheshin vepra kombëtare ose ndërkombëtare me studentë të Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”.⁶⁶</p> <p>Përsa i përket zhvillimit të praktikave profesionale, ato realizoheshin në ambientet e institucioneve të APU-së sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me këto institucione nga Fakulteti i Muzikës (Marrëveshja me ZVA Vlorë).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se UART vë në dispozicion të studentëve fagotistë mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin praktik të tyre duke respektuar natyrën dhe fushën e programit të studimit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literaturë bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në analizën e Syllabuseve të Planit Mësimor të Programit të Studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, konstatuam që literaturë bazë dhe ndihmëse e vënë për studentët fagotistë në gjuhën shqipe (fizike dhe/ose digjitale për Modulin A, C) dhe në gjuhën universale të muzikës (fizike dhe digjitale për Modulin B) garantonte marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. Kjo literaturë ofrohej dhe gjendej fizikisht në formë tekstesh dhe partiturash pranë Bibliotekës së UART ose fizikisht në formë leksionesh nga pedagogët e lëndëve;</p>

⁶⁵ Ibid.

⁶⁶ Ibid.

	ndersa në menyre digjitale ajo ofrohej përmes aksesimit të studentëve përmes faqeve online të internetit. ⁶⁷
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të vitëve të fundit.	Nga bisedat me pedagogë të këtij program studimi na u siguroi se përditësimi i literaturës realizohej përmes botimeve të partiturave muzikore mbi bazën e dorëshkrimit origjinal, përshtatjeve të materialeve të ndryshme muzikore për veglën fagot si dhe konform edhe veçorive individuale të studentëve të këtij program studimi. Gjithashtu, përditësimet respektive ishin bërë edhe përmes katalogut online të BSHUA lidhur me partet dhe partiturat e Edicionit Henle Verlag. ⁶⁸
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Theksojmë se organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Shkencore në UART përcaktohej në rregulloren e saj të miraturuar nga Senati Akademik. ⁶⁹ Referuar vizitës në Bibliotekës Shkencore të UART dhe bisedës me drejtoreshën e saj, u konstatua se për të gjithë studentët e Universitetit të Arteve, përfshirë këtu edhe studentët fagotistë, kjo njësi garantonte mundësi të barabarta shfrytëzimi të fondit të saj. Studentët mund të tërhiqnin materialet e tyre didaktike dhe muzikore përmes anëtarësimit në bibliotekë dhe përmes hapjes së një llogarie online për Arkivin digjital të BShUA. Në ambjentet e brendshme të BShUART, studentëve u vihej në dispozicion të tyre dy salla: sala e leximit dhe ajo multimediale me një kapacitet prej 20 vendesh dhe 20 kompjuterash.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas informacionit profesional të dhënë nga drejtoresha e bibliotekës (punonjëse që prej 34 vitësh në këtë bibliotekë), deklarojmë se Biblioteka e UART është Biblioteka e vetme e Artit që ekziston në Shqipëri. Biblioteka ishte themeluar para 60 vitesh, dhe datonte me themelimin e Fakultetit të Muzikës. Gjatë këtij harku kohor, biblioteka kishte pasuruar fondin e saj me dorëshkrime shumë të vyera, disqe, kaseta, libra, punime diplomash, etj., të cilat ishin edhe në proces të dixhitalizimit për t’ju vënë në dispozicion të të gjithë të interesuarve. Fondi i saj i mbyllur dhe ai i hapur, fizik dhe elektronik, ofronte për të gjithë studentët e UART dhe për studentët fagotistë, një fond jashtëzakonisht të pasur shqip dhe në gjuhë të huaj, me tekste, parte e partitura për zhvillimin e veprimtarive mësimore.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushtë për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në Bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se Biblioteka e UART ofronte mundësi të shfrytëzimit të literaturës online pa pagesë për të gjithë studentët. Ata kishin mundësi të aksesoheshin në arkivin digjital të BSHUA ⁷⁰ . Përmes aksesimit në bibliotekën online IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY ⁷¹ , studentët e programit të studimit “Fagot dhe Mësuesi”, mund të merrnin shërbime të tjera pa pagesë.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike	Referuar vizitës së zhvilluar në Bibliotekën e Universiteti të Arteve, konstatuam se biblioteka kishte përveç sallës së leximit, edhe sallën

⁶⁷ Ibid. fq. 90-91.

⁶⁸ Ibid.

⁶⁹ Statuti i UART, Neni 21, Pika 4. Evidenca I.I.1.2.1

⁷⁰ Katalogu online i BSHUA: <http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=344&niveli=60>. UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Fagot dhe Mësuesi”, fq. 93. Evidenca 1.

⁷¹ Ibid. IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY: <https://imslp.org/wiki/Main.Page>.

dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	multimediale, e cila ishte e pajisur me 20 kompjuterë të vënë në dispozicion të studentëve të saj. Nga biseda me drejtoreshën e bibliotekës na u siguroi se kompjuterat ishin të pajisur me programe të tilla si: office, adobe premier, finale, si dhe me pajisje teknike (kufie, printer dhe scanner). Këto pajisje mundësonin jo vetëm leximin e veprës muzikore por edhe dëgjimin e Interpretimit të muzikës nga të gjithë studentët e FM.		
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtëjtje, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që Biblioteka kishte të afishuar në një vend të dukshëm të saj oraret e shërbimeve sipas nevojave të studentëve. Këto orare përfshinin ditët gjatë zhvillimit të procesit mësimor (e Henë - e Enjte: 08:00-19:00; e Premte 08:00-16:00). Gjatë sezonit të provimeve, biblioteka qëndronte e hapur më një orar më të zgjatur.		
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga biseda me drejtoreshën e Bibliotekës së UART dhe nga shqyrtimi i RVB-së, konstatuam se Departamenti i Interpretimit ndjekin dhe raportojnë periodikisht për: cilësinë e fondit fizik dhe atij online të bibliotekës, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët. Po ashtu, përmes komunikimeve zyrtare, Departamenti i Interpretimit parashtronte kërkesat për tituj të rinj sipas nevojave të paraqitura, si dhe për performancën e personelit akademik. ⁷²		
Konkluzione	GVJ deklaron se FM, DI dhe Biblioteka e UART angazhohen plotësisht që të sigurojnë literaturën e nevojshme e të përditësuar për një mësimdhënie/nxënie efektive për studentët fagotistë. Ajo vë në dispozicion të studentëve fondin e saj të mbyllur dhe të hapur, fizik dhe elektronik, sallën e leximit dhe atë multimediale dhe në orare të përshtatshme për frekuentimin efektiv nga studentët. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

⁷² UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Fagot dhe Mësuesi", fq. 94. Evidenca 1.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas RVB-së, konstatim se UART disponon një sistem menaxhimi, përmes të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi". Menaxhimi i informacionit realizohet përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës dhe specialistes për sistemin PITAGORA - Sektorit mesimor, të Kurrikulave dhe Informimit të studentëve, - Drejtorisë së BNJ dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës - Sektorit të Statistikes - Sektorit të IT - Komisionit të Marrëdhënieve me Studentet (Statuti UART Neni 30/d, Neni 34). Menaxhimi elektronik i informacionit realizohet nga: <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare e UART në internet dhe rrjetet sociale http://www.uart.edu.al - Komunikimi përmes postës zyrtare email - Sistemi PITAGORA - Platforma online TEAMS.⁷³
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Konfirmohet se UART mbështeste sistemin e brendshëm të menaxhimit në Statutin ⁷⁴ e tij dhe kryente administrimin e informacionit, të dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelin administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", duke përditësuar të dhënat e dosjeve individuale, CV-të dhe dokumentacionit shoqëruar. Po ashtu, sistemi i brendshëm i menaxhimit përditësonte të dhënat e aktivitetit akademik, kërkues artistik (akt marrëveshja për kohën vjetore të punës me dokumente mbështetës), veprimtarisë ndihmëse akademike me karakter mësimor, artistik, shkencor, etj. ⁷⁵
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi PITAGORA ofron akses për secilin student dhe pedagog lidhur me të gjitha procedurat për provime, si: regjistrimin në provime, frekuentimin, paraqitjen e notave, gjenerimin e proces-verbaleve të provimeve dhe marrjen e vlerësimit në kohë reale të rezultatit të provimit. Për personelin akademik dhe ndihmës, komunikimi realizohet përmes shkëmbimit të e-maileve me Sektorin mësimor; të Kurrikulave dhe Informimit të studentëve; Drejtorinë e BNJ dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës; me Sektorin e Statistikes dhe IT-së.

⁷³ Ibid. fq. 95-96.

⁷⁴ Statuti i UART, Neni 78.

⁷⁵ Ibid, fq 97.

	Faqja zyrtare e UART ⁷⁶ , shërbente për njoftimet, informacionet e tjera mbi studentet, ambientet, aktivitetet, marreveshjet, organet drejtuese, personelin akademik, njoftimet për punësim, për projektet si dhe mbi fakultetet e UART dhe Bibliotekën Shkencore të UART.						
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga vizita në UART dhe nga aksesimi në faqen zyrtare të tij, konstatohet se Institucioni ka integruar platformën PITAGORA dhe TEAMS që u mundëson personelit dhe studentëve forma të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit.						
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik e administrativ realizohet përmes firmosjes fizike të listë prezencës së personelit akademik, çdo ditë pune pranë Sekretarisë mësimore. Raportimet individuale dhe të dhënat në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese, lidhur me veprimtarinë akademike e administrative të personelit të UART realizoheshin përmes kontrolleve të organizuara nga organet dhe autoritetet drejtuese. Platforma TEAMS, kishte shërbyer për raportimin ditor të veprimtarisë akademike në rastin e periudhës së pandemisë COVID-19. ⁷⁷						
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konstatohet se në faqen e tij zyrtare (http://uart.edu.al/) UART paraqet të gjithë informacionin lidhur me strukturën organizative, veprimtarinë akademike, artistike, bazën ligjore, programet e studimit, etj. Nga logimi në websitin e UART, konstatohet se informacionet publikoheshin nga Sistemi i menaxhimit të brendshëm në dy gjuhë ku njëra është gjuha shqipe. Informacionet kryesore lidhur me strukturën e organizimit të UART, publikoheshin edhe në gjuhën angleze.						
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se sistemi i brendshëm i menaxhimit në UART siguron administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi".</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mesimor-kërkimor, mbarevajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë	Raporti financiar i kostove të njësisë bazë të DI të FM në UART, së bashku me mbështetjen e nevojshme financiare për mbarevajtjen e

⁷⁶ Evidenca I.I.2.2.3 Informacion zyrtar në faqen web të Universitetit të Arteve.

⁷⁷ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Fagot dhe Mësuesi", fq. 99-100. Evidenca 1.

<p>bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>programit të studimit, përfshihej në parashikimet e Projekt buxhetit afatmesëm dhe në parashikimin e përvitshëm për financimin e të gjitha programeve të kësaj njësie.</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, burimet financiare të Njesisë Bazë DI, përlllogaritshin nga: Buxheti i Shtetit (Grandi i Politikave të Zhvillimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë; Grandi i mësimdhënies dhe Grandi i Punës Kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese) dhe të ardhurat e krijuara nga institucioni.⁷⁸</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar hartohet në nivel institucional dhe realizohet nga administratori dhe Drejtoria Ekonomike e UART, ndërsa Departamenti i Interpretimit paraqiste pranë kësaj drejtorie kërkesat për mbulimin e shpenzimeve financiare për programin e studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UART nuk i plotëson kushtet për kryerjen e auditimit periodik nga vetë institucioni për shkak të mos plotësimit të kriterëve të parashikuara, bazuar në VKM nr. 83, datë 3.2.2016.⁷⁹</p> <p>Universiteti i Arteve mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi nga Institucione eprore dhe të specializuara. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, UART nga viti akademik 2019-2020 e deri më tani, nuk i është nënshtruar ndonjë procesi auditimi.⁸⁰</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Referuar dokumenteve të dorëzuara, konstatohet se UART e realizon kriterin e raportimit tek Departamenti i Interpretimit në lidhje me realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës për programin e studimit “Fagot dhe Mësuesi” konform ligjeve në fuqi.⁸¹</p> <p>UART për çdo vit shkruan Raportin Vjetor⁸² i cili ndër të tjera përmban edhe analizën për veprimtarinë ekonomike të Universitetit. Kjo analizë përfshin shpenzimet buxhetore të vitit 2020 në rang universiteti.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njesisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për</p>	<p>Qëndrueshmëria financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njesisë bazë dhe të kapaciteteve financiare per ecurinë e tyre, garantohej nga Universiteti i Arteve përmes bazës ligjore: Ligjit nr. 80/2015 “Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor”; Ligjit nr.</p>

⁷⁸ Ibid, fq. 102-103.

⁷⁹ VKM nr. 83, datë 3.2.2016. Për miratimin e kriterëve të krijimit të njesisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik. fq. 2050 të Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 19, fq. 2050. <https://shukalb.al/wp-content/uploads/2019/07/VKM-Nr.-83-3.2.2016>

⁸⁰ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Fagot dhe Mësuesi”, fq. 104. Evidenca 1.

⁸¹ Udhëzimi Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/63>.

⁸² <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

<p>ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>10/296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Statutit të UART.</p> <p>Raporti financiar i kostove të Departamentit të Interpretimit në FM hartohet dhe dokumentohet nga institucioni, i cili së bashku edhe me projektin e buxhetit afatmesëm, garantonin ecurinë financiare dhe mbarëvajtjen e program të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi".⁸³</p> <p>Shpenzimet e buxhetit për vitin paraardhës jepen në Raportin Vjetor të UART 2020-2021. Ky buxhet paraqitet në rang universiteti dhe jo i detajuar sipas Fakulteteve përkatëse.</p> <p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, nuk evidentuam ndërhyrje të posaçme financiare për Fakultetin e Muzikës dhe Departamentin e Interpretimit, i cili është përgjegjës për programin "Fagot dhe Mësuesi".</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ deklaron se Universiteti i Arteve garanton mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor-kërkimor sipas kërkesave që ai ka, mbarevajtjen e programit dhe mbeshtetjen e studentëve.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në</p>	<p>Konfirmojmë se institucioni operon me procedura të strukturuar mirë, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në funksion të studentit. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, Rregullorja e UART, ajo mësimore për Ciklin e dytë të studimeve dhe Plani i zhvillimit strategjik i UART,⁸⁴</p>

⁸³ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Fagot dhe Mësuesi", fq. 106. Evidenca 1.

⁸⁴ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025. Evidenca I.I.1.1.3. VKM 780 datë 26.12.2018 Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	garantonin zbatimin e të gjitha procedurave që nga hyrja dhe deri në diplomimin e studentëve të këtij program studimi.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Fakulteti i Muzikës dhe DI garantonin barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë të Master i Arteve në "Fagot dhe Mesuesi" që nga momenti i aplikimit për pjesmarrje në konkurrim e deri në diplomim e tyre. Konfirmojmë se këto procedura ishin transparente meqënëse publikoheshin në faqen zyrtare të UART. Po ashtu, procedurat nuk ishin diskriminuese pasi bazoheshin tek legjislacioni dhe aktet nënligjore në fuqi: Rregulloret, Kodi i Etikës së UART ⁸⁵ , VKM 780 datë 26.12.2018. ⁸⁶
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Konstatuam nga bisedat e zhvilluara në institucion se, për vetë specifikën e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", pranimi i studentëve kryhej vetëm me konkurrim. ⁸⁷ UART hartonte dhe publikonte përpara çdo viti akademik rregullore dhe kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve të Ciklit të Dytë Master. ⁸⁸ Ndërsa bashkëpunimi me strukturat e maturës shtetërore, aplikohet vetëm për Programet e studimeve të Ciklit të Parë Bachelor sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga bisedat e qëllimta gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, konstatojmë se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve të këtij program studimi janë transparente dhe bëhen publike në faqen zyrtare të UART. Të gjitha procedurat zhvillohen dhe mbështeten konform en dy Rregulloreve të institucionit. ⁸⁹
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas Rregulloreve Mësimore të Ciklit të Dytë të Studimeve, si dhe sipas Kuotat e pranimeve në ciklin e dytë Master, në fillim të vitit akademik, studentët dhe të interesuarit e tjerë gjejnë të specifikuarat kriteret dhe udhëzimet për pranim në ciklin e dytë të studimeve. Universiteti i Arteve informonte të gjithë të interesuarit në dy mënyra: online dhe fizikisht. ⁹⁰
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, konstatuam që Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit përcaktojnë kuota pranimit të veçanta për përzgjedhjen e

⁸⁵ Kodi i Etikës së UART. <http://www.uart.edu.al/media/2020%20-%20vsa%20%2023.1%20KODI%20ETIKES.pdf>

⁸⁶ VKM 780 datë 26.12.2018 Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL. Evidenca II.1.6.5.

⁸⁷ <http://www.uarted.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASJER%202023-2024%20FM.pdf>

<http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASTER%202022-2023%20PM.pdf>

⁸⁸ http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr.%2019,%20Dt.%2010_03_2022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20pike%20zimit%20e%20konkurset%20e%20pranimit%20per%20vite%20akademik%202022-2023.pdf

⁸⁹ Rregullore e mësimore Cikli i dytë i studimeve Master.

Rregullore dhe kritere pranimit Master 2022-2023. Evidenca II.1.6.4.

⁹⁰ Ibid.

	kandidatëve me aftësi të vecanta apo të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. ⁹¹						
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Bazuar në Nenin 10, pika 5 të Rregullores Mësimore të Ciklit të Dytë Master, bëhej hartimi i të gjitha kriterëve për përzgjedhjen e kandidateve nga shtete të tjera. Konstatuam se përpara çdo viti akademik, UART, Fakulteti i Muzikës dhe DI, publikonte përpara çdo viti akademik të gjitha këto kriterë.						
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Konfirmojmë që UART harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë mbështetur në akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe i zbaton ato me Vendim të Bordit të Administrimit të UART. ⁹² Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, UART për rritjen e cilësisë së pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit, nuk ka aplikuar për politika të veçanta promovuese të programeve të studimit, sepse pranimet në Ciklin e Dytë të Studimeve Master, kërkojnë një cilësi më të lartë se mesatarja dhe marrin parasysh gjithashtu kërkesat e tregut të punës për cilësi të të diplomuarve.						
Konkluzione	<i>GVJ deklaroi se UART harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedurë që nga pranimi i studentëve fagotistë dhe deri tek diplomimi i tyre konform kuadrit ligjor në fuqi dhe dokumenteve strategjike të institucionit.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar bisedave të zhvilluara me anëtarët e DI-së, konstatuam se kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe ato të kalimit nga njëri vit në tjetrin për studentët e Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, u shpjegoheshin me hollësi secilit prej tyre si nga pedagogët ashtu edhe nga specialisti për kurrikulën dhe informimin. Gjithashtu, ky informacion mbështetej dhe realizohej konform Rregullores mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë në nenet: 17 deri në 23.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të	Bazuar në bisedat e qëllimta të zhvilluara në institucion, pohojmë se specialisti për kurrikulën dhe informimin e studentëve i njoftonte studentët fagotistë për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose

⁹¹ [http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr %2019,%20Dt %2010 03 2022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20pikë zimit%20e%20konkurset%20e%20pranimit%20per%20vitin%20akademik%202022-2023.pdf](http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2019,%20Dt%2010%2003%2022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20pikë%20zimit%20e%20konkurset%20e%20pranimit%20per%20vitin%20akademik%202022-2023.pdf)

⁹² Urdhëri 159, datë 09.11.2021 Përrjashtimi nga tarifa e shkollimit. Evidenca I.I.3.1.

kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	studimeve të pjesshme konform Neneve 24 deri tek 28 të Rregullores Mësimore të Studimit të Ciklit të Dytë Master.						
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga analiza e dokumenteve të dorëzuara nga Departamenti i Interpretimit, vërejtëm se çdo program lëndor dhe modul përkatës përmbante të specifikuar në Syllabuset ⁹³ e tyre kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve për njohuritë e tyre. Këto kriteret u bëheshin me dije studentëve përmes pedagogut të lëndës. Po ashtu, në Rregullorjen e programit të studimit të ciklit të II, përcaktoheshin qartë të gjithë procedurat e vlerësimit të studentëve që nga mënyrat e të provuarit të dijës, kushtet e kalimit në vitin pasardhës e deri tek mënyrat e përmirësimit të notave (Nenet 17 - 23).						
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të studentëve, përcaktoheshin qartë në Rregulloren e programit të Studimit të Ciklit të II, përkatësisht në Nenet 30 – 36 të saj. Konstatuam që institucioni i njëjti studentët me këto kriteret deri në mbrojtjen e diplomës apo dhënien e provimit përfundimtar.						
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përmes Ditëve të hapura dhe Zyrës së informimit të studentëve dhe të këshillimit të karrierës u bëhej e mundur studentëve fagotistë të merrnin informacion në lidhje mbi mundësitë dhe kuotat për vazhdimin e studimeve të tyre në Master në “Fagot dhe Mësuesi”. Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, përveç këtyre mënyrave, rezultoi se informimin kryesor studentët e merrnin përmes kontakteve personale me pedagogët e lëndës speciale.						
Konkluzione	<i>GVJ deklaron se informacioni mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve e deri në përfundim të studimeve dhe marrjes së diplomës i vënë në dispozicion të studentëve fagotistë nga UART, është i plotë dhe i hollësishëm.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit!	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rezultoni se Fakulteti i Muzikës dhe DI operojnë me dokumente ⁹⁴ në të cilat përcaktohen qartë mënyrat e informimit të studentëve për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës.

⁹³ Syllabuset e programit të studimit “Fagot dhe Mësuesi.

⁹⁴ Statuti i UART dhe Rregullorja e studimit të ciklit të dytë të studimeve.

	Sipas bisedave të zhvilluara në institucion me studentin fagotist, konfirmojmë se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzbatjen e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” përmes Zyrës së informimit të studentëve dhe të këshillimit të karrierës, përmes Syllabuseve të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” ⁹⁵ dhe Planit mësimor ⁹⁶ për këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në RVB, rezulton se në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i lëndëve, ngarkesa javore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar. Konstatuam se studentët fagotistë kishin dijeni për çdo disiplinë, modulet specifike, praktikën mësimdhënëse, praktikën artistike dhe detyrimet për shlyerjen e çdo lënde.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informimi i studentëve rreth mundësive të tyre për punësim me kohë të plotë si instrumentistë në orkestrat e ndryshme apo në Arsimin Parauniversitar ose punësim me kohë të pjesshme si personel shtesë në institucionet e produksionit kulturor publik dhe jopublik, realizohej nga UART dhe Fakulteti i Muzikës. Një mbështetje tjetër për studentët, shërbente edhe platforma online GRADUA (pjesë e projektit GRADUA). Përmes saj bëhej orientimi i studentëve për në tregun e punës. Pas regjistrimit të studentëve në këtë platformë, ata kishin mundësi të krijojnë kontakte të drejtpërdrejta me tregun e punës. ⁹⁷
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Konfirmojmë se studentët fagotistë të Masterit mermin një informacion të plotë lidhur me organizimin e procesit mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme përmes sekretarisë mësimore, dokumenteve të shpallura në mjediset e Fakultetit të Muzikës dhe faqes zyrtare të UART. Kjo e drejtë e studentit përcaktohej qartë tek Rregullorja e ciklit të dytë të studimeve në UART. ⁹⁸ Bazuar dhe në specifikat e zhvillimi të lëndëve speciale në DI, ku një pedagog bën mësim vetëm me një student, çdo student kishte mundësinë të informohej për gjithçka nga pedagogu i tij personal, i cili ishte edhe këshilltari i tij akademik. ⁹⁹
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Konfirmojmë se studentëve të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” u vihej në dispozicion i gjithë informacioni që u duhej përmes sistemit elektronik dhe atij fizik. Informacioni elektronik u mundësohej studentëve përmes mbulimit me internet dhe sistemit PITAGORA. Ndërsa informacioni fizik mundësohej nëpërmjet Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, strukturës administrative dhe asaj ndihmës akademike.

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ Plani mësimor Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”.

⁹⁷ Një informacion mbi projektin GRADUA në faqen zyrtare të UART. <http://uart.edu.al/index.php?id=845>
Rregjistrimi online i studentëve: <https://gradua.rash.al/stud/registration/Default.aspx?codepla=1&lang=sq>

⁹⁸ Rregullore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në Universitetin e Arteve. Neni 39.

http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF

⁹⁹ Rregullore mësimore e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, Neni 41.

Konkluzione	<p><i>GVJ deklaroi se Fakulteti i Muzikes dhe Departamenti i Interpretimit vënë në dispozicion të studentëve fagotiste informacion të hollësishëm në lidhje me strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit si dhe mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore të FM në UART, evidentuam se UART ka statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Të dhënat përpunoheshin sipas specifikës së programit të studimit.</p> <p>Si nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni¹⁰⁰, ashtu edhe nga vizita e zhvilluar në Sekretarinë mësimore, konstatuam se numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit “Fagot dhe Mësuesi” për katër vitet e fundit ishte:</p> <p>Viti akademik 2019-2020, 2 studentë Viti akademik 2020-2021, 2 studentë; Viti akademik 2021-2022, 1 studentë; <u>Viti akademik 2022-2023, 0 student.</u></p> <p>Totali 5 studentë Të diplomuar 4 studentë.</p> <p><i>Konstatohet numri shumë i ulët i studentëve të masterit në “Fagot dhe Mësuesi”.</i></p> <p><i>Rekomandojmë gjetjen e mekanizmave të duhur për rritjen e numrit të studentëve fagotistë të Masterit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Vertetojmë se UART mbante evidenca të plota mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të studimeve apo mospërfundimet me sukses të vitit akademik. Vizita dhe biseda e zhvilluar në Sekretarinë mësimore konfirmoi se të dhënat dokumentoheshin në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e Arritjeve¹⁰¹ dhe sistemin PITAGORA.</p> <p>Po ashtu, nga shqyrtimi i Analizës Vjetore të institucionit, konstatojmë se UART çdo vit akademik paraqet pranë MAS, Raportin Vjetor të veprimtarisë së tij. Ndër të tjera, raporti përmban informacione lidhur</p>

¹⁰⁰ Evidenca: Të dhëna studentësh.

¹⁰¹ Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Arritjeve. Evidencat V.4.3.1 dhe V.4.3.2.

	me numrin aktual të studentëve, largimet dhe numrin e të diplomuarve për çdo program studimi. ¹⁰²
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Rezultoi se sistemi i brendshëm i informacionit realizonte menaxhimin e informacionit dhe të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” ishin të sigurta dhe lehtësisht të vetifikueshme nga personat e autorizuar. Sektori i Statistikës dhe Informacionit në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Muzikës, ishin përgjegjës për hedhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre në sistemin PITAGORA.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me aktë, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Universiteti i Arteve mbështet me akte kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.) përmes Rregullores së Sektorit Mësimor. ¹⁰³ Referuar kësaj rregulloreje, konfirmojmë se Sektori Mësimor, kryente kontrolle periodike për verifikimin e saktësisë së informacionit në formë elektronike dhe fizike pranë Fakulteteve të Universiteti të Arteve, përfshirë Fakultetin e Muzikës, për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave. Po ashtu, Sektori Mësimor i kërkonte njësisë bazë Departamentit të Interpretimit informacion për gjithë dokumentacionin e administruar prej tyre.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raportë analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojmë që në Raportin vjetor që hartohet nga Departamenti i Interpretimit merreshin në shqyrtim dhe krahasohej profili dhe cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve fagotistë. Sektori Mësimor në bashkëpunim me specialistën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, siguronin të dhëna rreth punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Referuar dokumentit të RVB-së (fq. 121), riorganizimi i Programit të Studimit Cikli i Dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” përmirësoi ndjeshëm treguesit e punësimit të diplomantëve fagotistë të FM. Duke marrë në konsideratë specifikën e instrumentit dhe numrin e studentëve fagotistë, ishin punësuar në Arsimin Parauniversitar: <ul style="list-style-type: none"> - nje diplomant në Elbasan - një diplomant (Korçë) - një në Liceun Artistik, Shkodër - dy në OFFA Me hapjen e Orkestres së Forcave të Armatosura, u krijuan mundësitë për punësim të të rinjve fagotistë për 2 vende pune permanentë.
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaroi se strukturat administrative të UART realizonin mbledhjen, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve jo vetëm përgjatë rrugëtimit të tyre deri në diplomim por edhe të dhënat e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve.</i> Rekomandojmë gjetjen e mekanizmave të duhur për rritjen e numrit të studentëve fagotistë që studiojnë në master. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i>

¹⁰² Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021, fq. 38. http://uart.edu.al/media/VSA22_dt23122021.pdf

¹⁰³ [http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr %2021,%20dt %2007 10 2021](http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr%202021,%20dt%2007%2010%2021)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas aktëve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas takimit me studentët që studionin në Departamentin e Interpretimit dhe grupin e GVB-së, konfirmojmë se institucioni zbaton përfshirjen e studentëve në struktura të përhershme ose ad-hoc konform detyrimeve ligjore, Statutit të UART ¹⁰⁴ dhe rregulloreve të saj. Konfirmojmë se inkurajohej pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lire dhe shprehjen e mendimit të tyre, në: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Senat akademik (2 studentë) ▪ Këshillin e Etikës (1 student) ▪ Komisionin e përhershëm të marrëdhënieve me studentët (1 student) ▪ Këshillat studentorë ▪ Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të akreditimit institucional ▪ Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”¹⁰⁵.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkretë, frutdhënëse dhe me rezultatë lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Konstatuam se UART dhe FM garantonte përfshirjen reale të studentëve në vlerësimet e ndryshme që u kërkohen të bënin. Studentët ishin faktor me peshë në proceset e përmbushjes së programit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe RVB-së së programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, rezultoi se studentët ishin aktiv në vlerësimin e cilësisë së stafit akademik. Mendimi i secilit prej tyre tërhiqej për vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorëve rreth veprimtarive mësimore, shkencore dhe artistike. ¹⁰⁶
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Konfirmojmë që, Departamenti i Interpretimit, përmes rregulloreve të dorëzuara, lejon përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të programit të studimit dhe reflekton sugjerimet e tyre. Në pyetësorin e zhvilluar në Maj të 2022, studentët shprehnin mendimet e tyre në lidhje me vështirësitë që ata kishin dhe jepnin sugjerime rreth çështjeve që kishin nevojë për rishikim dhe përmirësim.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve,	Gjatë bisedës së zhvilluar me studentin fagotist nuk identifikuam ndonjë rast ankimit të studentit lidhur me kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Konfirmojmë se provimet me shkrim

¹⁰⁴ Statuti i UART, Neni 126.

¹⁰⁵ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Fagot dhe Mësuesi”, fq. 104. Evidenca 1.

¹⁰⁶ Rezultatet e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	u nënshtroheshin procesit të sekretimit ¹⁰⁷ duke dëshmuar për barazi të procesit të vlerësimit dhe paanshmëri në vlerësimin e studentëve. Përmes Rregullores mësimore të programit të ciklit të dytë Master ¹⁰⁸ përcaktohej qartë dhe garantohej mundësia e çdo studenti për të bërë kontestim të rezultatit, ankimim të notës dhe rishikim të saj nga njësia bazë apo nga pedagogu përgjegjës.		
Konkluzione	<i>GVJ deklaroi se UART përfshirja dhe angazhimi i studentëve fagotistë në organet vendimmarrëse e këshilluese, bëhej konform legjislacionit në fuqi dhe dokumenteve strategjike të këtij institucioni.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e informimit të studentëve është Statuti i UART dhe Udhëzimi Nr.27 datë 29.12.2017. ¹⁰⁹ Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga FM dhe DI, konfirmojmë që në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, UART vë në dispozicion Sekretarinë Mësimore pranë FM, Specialistin për informimin e studentëve, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni të përfshirë në Sektorin Mësimor pranë Rektoratit të UART.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe bisedave gjatë vizitës në institucion, konfirmojmë se për përmbushjen e këtij kriteri, përveç Sekretarisë mësimore të FM-së, specialistit për informimin e studentëve të cilët bëjnë këshillimin fizik të studentëve, dhe përveç komunikimit online (faqja zyrtare e Universitetit), UART ndjek edhe një praktikë tjetër. Secili i student fagotist asistojë gjatë procesit mësimor nga këshilltati i tij akademik, i cili ishte pedagogu specialist i vegëls muzikore. ¹¹⁰
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	Sipas dokumentit të RVB-së dhe bisedave të qëllimta të zhvilluara me përfaqësues të institucionit, konfirmojmë se këshillimi i karrierës për studentët fagotistë të masterit dhe orientimi për praktikën profesionale dhe për tregun e punës kryhej nga: Këshilluesi akademik, ¹¹¹ Sektori

¹⁰⁷ Sekretim provimi (foto). Evidenca III.3.2.2.

¹⁰⁸ Rregullore mësimore e ciklit të dytë studimeve Master në Universitetin e Arteve. Neni 23.

http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF

¹⁰⁹ Udhëzimi Nr.27 datw 29.12.2017. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Udhëzimi_nr_27_dt.29.12.2017

¹¹⁰ Rregullore mësimore e programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", Neni 40, 41.

http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF

¹¹¹ Ibid, Neni 41.

<p>periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mësimor dhe specialistja për Informim dhe Këshillim Karriere dhe Alumni.</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoritetëve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Bazuar në bisedat në institucion, rezultoi se gjurmimi i studentëve fagotistë pas diplomimit dhe sigurimi i të dhënave rreth punësimit të tyre, realizohej nga Sektori Mësimor në bashkëpunim me specialisten e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Të dhënat e siguruar, i vinin në dispozicion të organeve drejtuese dhe studentëve. Një tjetër instrument i cili siguronte të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve fagotistë, ishte edhe platforma GRADUA.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet e mësipërme, Grupi i GVJ deklaron se UART siguron, përmes njësive të ngriturat të saj, një shërbim cilësor për studentët jo vetëm në zhvillimin e procesit mësimor dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera, por edhe dhe orientimin në tregun e punës.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, stafi akademik i FM-së dhe i DI-së i jepte një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies sipas natyrës së lëndëve /moduleve të këtij programi të studimit. Nga drejtuesi i D-së dhe nga stafi i pedagogëve na u shpjegua se për vetë specifikën e lëndëve të Interpretimit individual apo në grup, është atribut i pedagogut të lëndës që të krijojë për secilin student një metodë të personalizuar dhe inovative të mësimdhënies. Sipas tyre dhe sipas Rregullores së programit të studimit¹¹² treguesit e synuar për t'u arritë në përfundim të studimeve Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi", janë individualiteti dhe originaliteti. Prandaj konkludojmë që aplikimi në mënyrë të unifikuar i planit mësimor dhe repertorit të përcaktuar varen shumë nga individualiteti dhe karakteristikat e secilit student.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik dhe ndihmës akademik vlerësoheshin në mënyrë periodike sipas dy niveleve: në nivel Departamenti dhe në nivel universiteti, përmes Analizave vjetore të Departamentit të Interpretimit,¹¹³ dhe Analizave vjetore të Universitetit të Arteve.¹¹⁴</p> <p>Sipas bisedës së zhvilluar me drejtorin e Departamentit të Interpretimit, na u siguria se Grupi mësimor dhe drejtuesi i DI-së zhvillonin mekanizmat e mëposhtëm të monitorimit të personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorë të administruar nga Sektori Mësimor dhe Fakulteti i Muzikës, të cilat plotësoheshin si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët. - Përpunimin e të dhënave të aktivitetit kërkimor artistik e metodologjik pedagogjik të personelit akademik. <p>Tregues tjetër i monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik ishte edhe numri i madh i koncerteve artistike që organizonin pedagogët dhe studentët e Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit dhe suksesi që ata arrinin në skenë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe trajtimit të ankimimeve, realizohej nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve me studentët.¹¹⁵ Secili student në fillim të vitit akademik nënshkruante një marrëveshje në të cilën ai shprehte dëshirën për përzgjedhjen e pedagogut të lëndës speciale. Kjo praktikë tregonte qartë për mënyrën demokratike të përzgjedhjes dhe mundësinë që i krijohej studentit të vendoste për</p>

¹¹² Rregullore e programit të studimit (Neni 8).

¹¹³ Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca I.1.3.1.1.

¹¹⁴ Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike Kërkimore Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021, fq. 31. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

¹¹⁵ Rezultatet e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

	vazhdimësinë e studimeve për veten e tij. Studentët ndiheshin të lirë të thonin mendimin e tyre, të ndryshonin pedagogun vitin e ardhshëm nëse nuk ishin të kënaqur, të sugjeronin zgjidhje të mundshme në lidhje me problematikat që hasnin gjatë përditshmërisë së tyre.		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në- mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	UART, FM dhe DI hartojnë dokumentin e Analizës vjetore të punës së këtyre njësive duke paraqitur arritjet aktuale dhe çështjet që kanë nevojë për përmirësim për një cilësi më të lartë në mësimdhënie. Këto të dhëna sugjerohen nga njësia bazë dhe nga njësia e Sigurimit të Cilësisë. Bazuar mbi shqyrtimin e Analizës vjetore të punës në UART ¹¹⁶ , konfirmojmë se rezultatet e vlerësimit bëhen publike nga kjo njësi.		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultatëve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Përmes dokumentacionin të dorëzuar nga FM ^{117, 118} , evidentuam se Universiteti i Arteve, promovonte shembuj të praktikave të mira, nxiste personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies përmes analizave vjetore dhe konkluzioneve të tyre. Këto mekanizma vlerësimi shërbenin për ruajtjen e standardeve të cilësisë si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies.		
Konkluzione	<i>GVJ deklaroi se Universiteti i Arteve siguronte garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët ndiheshin të lirë të jepnin mendimin e tyre përmes zhvillimit të pyetësorëve dhe bënin sugjerimet përkatëse.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ deklaroi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) në UART është ngritur dhe funksionon në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi ¹¹⁹ dhe dokumentet strategjike të institucionit. ^{120, 121} Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe nga vizita në FM, konfirmojmë se UART ka ngritur Komisionin e ad-hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Fakulteti i Muzikës bashkëpunon me NjSBC dhe zbaton detyrat në përputhje me Rregulloren e NjSBC-së. ¹²²

¹¹⁶ UART - Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

¹¹⁷ Ibid.

¹¹⁸ Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca I.I.3.1.1.

¹¹⁹ Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Neni 103. Evidenca I.I.1.1.1.

¹²⁰ Statuti i UART. Neni 135, 136.

¹²¹ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025. Evidenca I.I.1.1.3.

¹²² UART - Rregullore e Funksionimit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

<http://www.uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2024,%20dt%2007%202021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rre>

	Numri i anëtarëve të NjsBC pëcakohej edhe sipas Nenit 5 të kësaj rregulloreje.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas bisedës me përfaqësues të NjsBC-së, kjo njësi është ngritur nga UART me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Na u konfirmua se NjsBC-ja funksiononte si kupolë dhe ndihmonte në organizimin e punës të sektorëve të tjerë të UART me qëllim krijimin e frymës së bashkëpunimi ndërmjet strukturave të brendshme në institucion. NjsBC garantonte sinkronizimin e informimin periodik për çdo veprimtari të programit dhe tregonte një vëmendje të veçantë të përfshinte studentët në ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies. Po sipas bisedës së zhvilluar me anëtarët e kësaj njësie, konfirmojmë se NjsBC e ndërtonte punën në mënyre transversale që nga Njësitë Bazë deri në Rektorat, me mbështetjen e Sektorit mësimor, të Kurrikulave dhe Informimit të studenteve, duke u koordinuar me sekretaritet mësimor të secilit fakultet.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentët dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, UART orientohej nga Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe përdorte Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me elementët e tij përbërës dhe Standardet e Kriteret respektive të tyre sipas: Rregullores së NjsBC, Statutit të UART dhe Ligjit 80 2015. Qëllimi ishte përfshirja në procesin e SBC e të gjitha strukturave akademike që nga DI e deri në Rektorat, si dhe përfshirja e studentëve. Për promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, shërbente edhe sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë. Ky proces realizohet nga ASCAL përmes vlerësimit të jashtëm të akreditimit dhe vlerësimeve analitike e krahasuese me kërkesë nga rektorati i UART ¹²³ . Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga FM dhe bisedës me drejtuesin e NjsBC-së, UART vjen në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit pasi ka kaluar me sukses dhe ka marrë Vendimin nga Bordi Akademik për Akreditimin institucional për 6 vite ¹²⁴ . Ky vlerësim i programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” po bëhet në kuadër të akreditimit periodik.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktët rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Sipas bisedës së zhvilluar me të gjithë përfaqësuesit e NjsBC-së, konstatoam se anëtarët e saj kanë njohje të detajuar të detyrës që kanë në institucion duke qenë se kjo njësi përbëhej nga të gjithë drejtorët e departamenteve të UART. NjsBC-ja e mbështeste veprimtarinë e saj në detyrimet që derivonin nga dokumentet strategjike si: Statutin e UART, Planin e Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025 dhe në Rregulloren e Funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

[gullores%20të%20Funksionimit%20të%20Njesise%20se%20Sigurimit%20të%20Brendshem%20të%20Cilesise,%20One%20UART.PDF](#)

¹²³ Ibid, Neni 11.

¹²⁴ Vendimi i BA per Akreditimin institucional, Nr. 17, datë 24/03/2022. <https://ëëë.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-24-mars-2022>

Adresa: “Ruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



53

	<p>Analizat vjetore të çdo njësie: DI, FM dhe atë të UART¹²⁵, dhe kontrollet teknike semestrale e vjetore pasqyronin gjendjen ekzistuese, arritjet dhe dobësitë të programit të studimit Master i Arteve në "Fagot dhe Mësuesi".</p> <p>Referuar bisedave në institucion dhe duke marrë parasysh specifikën e këtij program studimi, themi që promovimi nxitës për arritje me të mira lidhet me aspekte të originalitetit, kreativitetit dhe bagazhit kulturor dhe shpirtëror të studentit. Promovimi i praktikave të mira realizohej përmes organizmit të koncerteve dhe skena ishte një nga treguesit më të fuqishëm të suksesit të programeve të DI në FM. Prandaj theksojmë se këto tregues në UART janë krejt të ndryshëm nga treguesit cilësorë në programe studimi të universiteteve të tjera.</p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ deklaroi se UART hartoi dhe zbatoi politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, UART orientohej nga Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe përdorte Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me elementet e tij përbërës dhe Standardet e Kriteret respektive të tyre sipas Rregullores së NJSBC, Statutit të UART dhe Ligjit 80 2015.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultatëve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatët e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të</p>	<p>Njësia përgjegjëse për rishikim dhe mbikëqyrje periodike të programit nga plani deri tek syllabueset, është Departamenti i Interpretimit. Konfirmojmë që mekanizmat kryesorë që përdornin FM dhe DI për analizimin dhe dokumentimin e ecurisë së programit të studimit ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i Analizës vjetore të DI, e cila pasi diskutohet në rang departamenti, i përcillet dekanit të FM dhe më pas Rektoratit. 2. Pyetësorët që zhvilloheshin në nivel Fakulteti dhe Universiteti.¹²⁶ <p>Rezultatet e vlerësimeve pasi dokumentoheshin, ndiqnin rrugën institucionale dhe u bëheshin të njohura strukturave përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>

¹²⁵ Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca II.3.1.1. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021.
<http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

¹²⁶ Rezultatët e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

<p>njohura autoritetëve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Një tregues tjetër i ecures së këtij program studimi ishte edhe numri i koncerteve që organizonte FM. Ky tregues është është i një rëndësie të veçantë për Fakultetin e Muzikës sepse nënkupton produktin artistik konkret. Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve fagotistë pjesëmarrës në koncerte nga publiku, theksonte suksesin e këtij program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Konstatuam që raporti në të cilën adresoheshin të gjithë problematikat dhe të gjithë arritjet pozitive të punës mësimore dhe artistike të DI-së, ishte Analiza vjetore 2021-2022 e këtij departamenti. Raporti evidentonte arritjet e objektivave didaktike dhe artistike si për personelin akademik ashtu edhe për studentët. Po ashtu, në këtë dokument bëhej edhe adresimi i mangësive të këtij program studimi. Numri i madh i koncerteve të organizuara në periudhën Prill-Qershor 2022 (60 të tilla) në kuadër të 60 vjetorit të krijimit të Fakultetit të Muzikës, ku 90% e pjesëmarrësve ishin studentë dhe pedagogë nga Departamenti i Interpretimit, ishte ndër treguesit më domethënës të nxitjes së motivimit si të studentëve ashtu edhe të stafit akademik të profesorëve.</p> <p>Numri i kufizuar i projekteve kërkimore dhe shkencore të stafit akademik, konfirmon edhe njëherë specifikikën e veçantë të Fakultetit të Muzikës, i cili nuk funksionon si fakultetet e tjera. Referuar bisedave me anëtarët e DI dhe me komisionin e NJSBC, dhënia e Statusit të veçantë të UART, ia bëri të mundur pedagogëve të FM-së njehsimin e një aktiviteti artistik me një aktivitet shkencor. Kjo për arsye se sukseasi i arritjeve të stafit akademik të këtij Fakulteti matet me numrin e koncerteve dhe aktiviteteve artistike që organizon.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, tëstime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në tëstime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas RVB-së¹²⁷, konfirmojmë që për vlerësimin e programit të studimit, UART përdorte një sërë metodash, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimin e procesit të mësimdhënies; - Vlerësimin e lëndëve nga studentët; - Rezultatet në provime të studentëve; - Rezultatet e studentëve në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit; - Rezultatet në aktivitetet artistike; - Vëzhgimet gjatë kryerjes së praktikës; - Tëstimet lokale të kryera për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit; - Rezultatet e punimeve të diplomave. <p>Bazuar në Rregulloren e funksionimit të Njsbc-së në UART¹²⁸, përveç metodave të mësipërme, UART dhe FM e mbështeste monitorimin e procesit të sigurimit të cilësisë edhe përmes komenteve nga stafi akademik, nga studentët, nga ALUMNI dhe nga takimet e zhvilluara me pedagogë të jashtëm (ekspertë të fushës). Këta të fundit, ftoheshin</p>

¹²⁷ UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Fagot dhe Mësuesi", fq. 135. Evidenca 1.

¹²⁸ UART - Rregullore e Funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Neni 9.

<http://www.uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2024,%20dt%2007%2010%2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20të%20Funksionimit%20të%20Njesise%20se%20Sigurimit%20të%20Brendshem%20të%20Cilesise,%20One%20UART.PDF>

	për të diskutuar në mbledhjet e FM dhe ofronin ekspertizën e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.		
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumentë të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Mbështetur në bisedat e realizuara në UART dhe nga dokumentacioni i dorëzuar (RVB), konfirmojmë që vlerësimi i programit bëhej periodikisht. Për këtë, FM aplikonte metodologji miks. Ndër metodat e tërthorta që përdorte DI-ja, ishin: <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i pedagogëve të DI-së për cilësinë e programit të studimit. - Vlerësimi i numrit të stafit akademik të punësuar pranë DI-së. Konstatohet se përqindja më e madhe e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në DI, janë diplomantë të UART sipas programeve specifike, dhe ky është një tregues suksesi. - Ndjekja e ecurisë artistike të studentëve të diplomuar pranë këtij Universiteti . Ndjekja e karrierës së studentëve të UART pas diplomimit, konfirmon se një pjesë e mirë e tyre kanë një karrierë ndërkombëtare. Platforma GRADUA siguronte një database të studentëve të punësuar në institucione të ndryshme. - Punësimi i alumnit i Departamentit të Interpretimit, pranë institucioneve publike artistike dhe kulturore si orkestra, shkolla të mesme artistike Tiranë dhe rrethe, në TV shtetëror dhe ato private, etj., dëshmon për suksesin e arritur të këtij departamenti. 		
Konkluzione	<i>GVJ deklaron se UART monitoronte dhe vlerësonte në mënyrë periodike programin e studimit me anë të një sërë metodash të larmishme, duke siguruar nje cilësi të vazhdueshme te tij. UART dhe FM e mbështeste e procesin e sigurimit të cilësisë përmes komenteve nga stafi akademik, studentët, nga ALUMNI dhe nga takimet e zhvilluara me pedagogë të jashtëm (ekspertë të fushës).</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI. 4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatët dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar bisedës me grupin e NjSCB-cë dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, vumë re se: në funksion të garantimit të cilësisë së programit, ishin të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në kuadër të rritjes së cilësisë shërbenin edhe bashkëpunimet me punëdhënësit gjatë zhvillimit të praktikave mësimore të studentëve pranë tyre. Pjesëmarrja e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë, garantohej nga Statuti i UART dhe Rregullorja e NjSBC-së.

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkretë për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Funksioni kryesor i NjSBC-së mbështetëj në Rregulloren e kësaj njësie dhe nënkuptonte sinkronizimin e veprimtarive së çdo njësie që garanton sigurimin e cilësisë. Konfirmojmë që sipas Rregullores së NjSBC¹²⁹, të gjithë aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë kishin detyrime dhe përgjegjësi konkrete institucionale. Strukturat akademike dhe administrative të angazhuara me detyra konkrete institucionale për matjen e cilësisë në FM, ishin: Departamenti i Interpretimit dhe stafi akademik i tij, koordinator i programit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, Zyra e karrierës, Sekretaria mësimore dhe studentët e këtij programi.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë që është përgjegjëse për SBC e programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi”, ishte Departamenti i Interpretimit. Sipas Analizës vjetore të punës së DI-së¹³⁰, konstatuam se ky departament pasqyrore në këtë raport të gjithë elementët si: realimin e objektivave didaktik dhe artistik të pedagogëve dhe studentëve; hapjen e programeve të reja, rekrutimin e pedagogëve të rinj, aktivitetin artistik të stafit akademik dhe studentëve, shkëmbimet Erasmus+ dhe ecurisë së projekteve shkencore. E gjithë analiza mbështetëj në përfshirjen e të gjithë anëtarëve të këtij departamenti, personelit ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe studentëve. Kjo përfshirje garantohej përmes dokumenteve startegjik të FM.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Urdhri i lëshuar nga dekani i Fakultetit të Muzikës për ngritjen e grupit të punës për realizimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm¹³¹, verteton shmangien e diskriminimit dhe të pabarazisë kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konstatojmë se ky urdhër, parashikonte përfshirjen e përgjegjësit të Njesisë Bazë DI, kryetarëve të grupeve mësimore, përfaqësuesit të administratës dhe të një student.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar¹³², garantimi dhe vlerësimi i cilësisë realizohej edhe përmes angazhimit të stafit të jashtëm akademik. Evidentuam se sigurimi i ekspertizës nga ekspertë të huaj për cilësinë e programit, bëhej e mundur nga zhvillimi i Masterklasave me pedagogë të huaj nga institucione homologe nga Europa. Kjo praktikë lejonte bërjen e krahasimit të metodologjive dhe mbi bazën e tyre, dhënien e sugjerimeve përkatëse. Një tjetër mundësi për përmirësime në këtë program studimi, ishin Shkëmbimet Erasmus +¹³³ si në mobilitetin e stafit të brendshëm akademik, ashtu edhe nga mobiliteti i studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ deklaron se UART përfshinte njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit. Dokumentet strategjikë të UART-it, garantonin pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë e SBC-së.</i></p>

¹²⁹ Ibid, Nenet 9, 11 dhe 12.

¹³⁰ Analiza vjetore e punës nw DI 2021-2022. Evidenca I.I.3.1.15.

¹³¹ Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master. Evidenca II.5.1.7.

¹³² UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm. Evidenca 1.

Analiza vjetore e punës nw UART 2021-2022. Evidenca I.I.3.1.15.

¹³³ Shkëmbimet Erasmus+ (foto). Evidenca I.I.2.5.2.

	<i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë në funksion të garantimit të cilësisë mbështeteshin nga Dokumentet strategjike të UART: Statuti dhe Rregullorja e UART dhe Rregullorja e NjSBC-së. Çdo veprimtari e inicuar nga KSBC ishte transparente dhe publike për studentët dhe të interesuarit. Referuar neneve të Rregullores së NjSBC-së ¹³⁴ , raportet e monitorimit u komunikoheshin organeve, strukturave dhe autoritetve përkatëse të UART. Raportet e vlerësimeve të stafit akademik, ndihmë akademik dhe administrative të marra nëpërmjet pyetësoreve të studentëve, u komunikoheshin individualisht personave përkatës.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatët e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në praktikën e ndjekur të UART me Akreditimin institucional, konfirmojmë që me përfundimin e procesit të akreditimit, UART shpall në faqen zyrtare të tij vlerësimin përfundimtar dhe është konform legjislacionit në fuqi duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe të dhënat personale. ¹³⁵
Kriteri 3. Rezultatët e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Referuar analizës së raportit mbi Akreditimin institucional të UART, konfirmojmë që raportet e vlerësimit në UART përmbajnë çështjet që kanë nevojë për përmirësim dhe dalin me rekomandime konkrete për këto çështje. Në dokumentin “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve” parashikohej që të krijohej një plan masash për zgjidhjen e rekomandimeve të bëra nga ky dokument. ¹³⁶ <i>Nuk konstatoam se ka një plan masash ku adresohen përmirësimet specifike apo të përgjithshme të problematikave të evidentuara.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Pririmi të besojmë se efektiviteti, impakti dhe monitorimi nga NjSBC-ja në funksion të përmirësimin të cilësisë së këtij program studimi është në nivelin e duhur.

¹³⁴ Rregullore e Funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Neni 8.

¹³⁵ <http://uart.edu.al/index.php?id=1109>

¹³⁶ Vendim nr. 17, datë 24.03.2022 Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve. <http://uart.edu.al/media/Vendim%20i%20BA%2017>

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar diskutimeve të zhvilluara në takimet e drejtpërdrejta me anëtarët e NjSBC dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të RVB-së rezulton se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik dhe studentët për t'i informuar ata për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ deklaron se raportet e vlerësimeve që zhvilloheshin nga zyra e SBC-së, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, u komunikoheshin individualisht personave, me qëllim ruajtjen e privatësisë së të dhënave personale. Institucioni parashikonte një plan masash për mënyrën se si do të përmirësoheshin dobësitë dhe problematikat e evidentuara nga akreditimi institucional, por një plan i tillë nuk u gjet. Rekomandojmë hartimin e një plani masash ku të adresohen problematikat e evidentuara nga Raporti i akreditimit institucional i UART-it.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Konfirmojmë se Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” është hartuar sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe mund të ndiqet vetëm në Fakultetin e Muzikës pranë Universitetit të Arteve në Tiranë.
2. Programi i studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” i përgatit studentët të aftë të ushtrojnë profesionin e mësuesit në arsimin parauniversitar përmes formimit të tyre jo vetëm nga ana artistike dhe kulturore, por edhe nga ana pedagogjike.
3. Personeli akademik që mbulon këtë program studimi është pothuajse staf i brendshëm (14 PAE/4 PAK) dhe shumë i kualifikuar, me tituj dhe grada akademike dhe me përvojë shumë vjeçare në orkestrën e TKOB, muzikë dhome e solo, duke siguruar përmbushjen ligjore të këtij kriteri dhe suksesin e këtij programi studimi.
4. Biblioteka e UART është e vetmja bibliotekë arti në Shqipëri, e cila me fondin e saj shkencor, muzikor, artistik dhe historik, ofron për studentët Fagotistë një katalog shumë të pasur me vepra të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj. Pasurimi i kësaj biblioteke me Katalogun e Shtëpisë së famshme gjermane Henle Verlag ofron për studentët e Fakultetit të Muzikës dhe veçanërisht të studentëve Fagotistë një mbështetje të madhe përmes opusit të veprave për fagot solo, në ansambël dhe parte orkestrash.
5. Aksesimi online dhe pa pagesë e studentëve oboistë në katalogun online të BSHUA dhe në International Library Petrucci – IMSLP, lejon marrjen në formate digjitale të fondit historik dhe arkivin e këtyre bibliotekave.
6. Infrastruktura mjedisore e ambienteve ku zhvillohet mësimi i lëndëve Fagot, muzikë dhome, BigBand, Orkestër Simfonike/frimore është rikonstruktuar me elementë modernë të ndriçimit natyral dhe led, sistem ngrohje-ftohje dhe e pajisur me rrjet interneti pa pagesë nga UART, duke mundësuar zhvillimin e veprimtarive muzikore e mësimore në kushte optimale.
7. Punësimi i të gjithë të diplomuarve të programit të studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” si instrumentistë në orkestrat e ndryshme dhe Ansamble, si specialistë në institucionet e produksionit kulturor dhe si mësues në institucionet arsimore parauniversitare publike dhe joblike në Tiranë dhe rrethe, janë një tegues cilësor i suksesit të këtij programi studimi.
8. Provovimi i fuqishëm i studentëve Fagotistë bëhej nga vetë Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit dhe realizohej përmes daljes në skenë dhe performimit të studentëve përkrah pedagogëve të tyre në koncerte të ndryshme.

Pika të dobëta

1. Numri i ulët i studentëve në Programin e studimit Master i Arteve në “Fagot dhe Mësuesi” (Standardi V.4, Kriteri 1).
2. Mungesa e një plani masash ku adresohen zgjidhjet e problematikave të evidentuara nga Raporti i Akreditimit Institucional i UART-it (Standardi VI.5, Kriteri 3).

Rekomandime

1. Gjetjen e mekanizmave të duhura dhe bashkëndim të punës së Departamenti të Interpretimit dhe FM me institucionet artistike të sistemit parauniversitar për ekuilibrimin e proporcionalitetit të numrit të nxënësve që studiojnë muzikë dhe futjes së tyre në klasat e instrumenteve të frymës (Standardi V.4, Kriteri 1).
2. Përpilimin e një plani masash konkrete me qëllim përmirësimin e problematikave të evidentuara nga Raporti i Akreditimit Institucional i UART-it (Standardi VI.5, Kriteri 3).

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Arts "Bassoon and Teacher" provided by the Higher Education Institution "University of the Arts"

Strengths and affirmations

1. We confirm that the study program Master of Arts in "Bassoon and Teacher" has been designed according to the legal requirements in force and can only be followed at the Faculty of Music at the University of Arts in Tirana.
2. The study program Master of Arts in "Bassoon and Teacher" trains students especially from the artistic and cultural side but also from the pedagogical side in terms of their future exercise of the teaching profession in pre-university Education.
3. The academic staff covering this study program is entirely internal and highly qualified staff, with academic titles and ranks and with many years of experience in the TKOB orchestra, chamber and solo music, ensuring the legal fulfillment of this criterion and the success of this study program.
4. The UART library is the only art library in Albania, which with its scientific, musical, artistic and historical fund, offers bassoonist students a very rich catalog of works by Albanian and foreign composers. The enrichment of this library with the Catalog of the famous German House Henle Verlag offers for the students of the Faculty of Music and especially for the bassoonist students a great support through the opus of works for solo bassoon, in ensemble and orchestral parts.
5. Online and free access of bassoonist students to online catalog of the Library of UART and to the Petrucci International Library – IMSLP, allows students to receive in digital formats the historical fund and archive of these libraries.
6. The environmental infrastructure of the premises, where Bassoon, BigBand, Symphonic/Wind Orchestra are taught, has been reconstructed with chamber music, modern elements of natural lighting and LED, heating-cooling system and equipped with a free Internet network from UART, enabling the development of musical and educational activities in optimal conditions.

7. Employment of all graduates of the study program Master of Arts in "Bassoon and Teacher" as instrumentalists in various orchestras and ensembles, as specialists in cultural production institutions and as teachers in public and non-public pre-university educational institutions in Tirana and districts, shows the success of this study program.
8. The powerful rehearsal of the bassoonist students was done by the Faculty of Music and the Department of Interpretation and was realized through the appearance on stage and the performance of the students alongside their teachers in various concerts.

Weaknesses

1. Low number of students in the Master of Arts study program in "Bassoon and Teacher" (Standard V.4, Criterion 1).
2. The lack of a plan of measures addressing the solutions to the problems identified by the UART Institutional Accreditation Report (Standard VI.5, Criterion 3).

Recommendations

1. Finding the necessary mechanisms and coordinating the work of the Department of Interpretation and the Faculty of Music with the artistic institutions of the pre-university system to balance the proportionality of the number of students studying music and their introduction to wind instrument classes (Standard V. 4, Criterion 1).
2. Compilation of a plan of concrete measures in order to improve the problems identified by the Institutional Accreditation Report of UART (Standard VI.5, Criterion 3).

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X